

**UNITED
NATIONS**
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 10.03.2006

T R A N S K R I P T
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 10.03.2006.GOD.

MARS – MART 2006

T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 10.3.2006

Seanca u mbajt në sallën solemne të Kuvendit të Kosovës dhe filloi në orën 11.

Seancën e kryesoi Naim Maloku, anëtar i Kryesisë.

ANËTARI I KRYESISË NAIM MALOKU

Ju dëshiroj mirëseardhje të nderuar deputetë. Fillojmë seancën.

Deputetë të nderuar, zonja. dhe zotërinj, më lejoni,që në fillim të seancës t'i përshëndes për prezencë: kryetarin e Kosovës z. Fatmir Sejdiun- të nominuarin për kryeministër z. Agim Çeku, përfaqësuesit e zyrave diplomatike në Kosovë, përfaqësuesit e KFOR-it dhe të gjithë mysafirët e pranishëm në sallë, gjithashtu edhe Qeverinë e Kosovës.

Rendi i ditës për këtë seancë u është shpërndarë deputetëve.

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Kryesisë dhe kryetar i Kuvendit të Kosovës, z. Nexhat Daci, me z. Kolë Berisha- deputet i Kuvendit të Kosovës si dhe të z. Fatmir Sejdiu me z. Sabri Hamitin për anëtar të Kryesisë së Kuvendit.
3. Zgjedhja e kryeministrit dhe e Qeverisë.

Në pajtim me rregullat 6 dhe 23 të Rregullores së punës, Kryesia e Kuvendit ka përgatitur dhe i propozon Kuvendit miratimin e rendit të ditës për seancën e sotme plenare. Sipas ftesës që u është shpërndarë të gjithë deputetëve, së bashku me materialin e duhur.

Kush është për këtë rend dite, ju lutem të deklaroheni.
Ju faleminderit. Shumica. A ka kundër? Nuk ka.
Konsideroj se është miratuar rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Kryesisë dhe kryetar të Kuvendit të Kosovës z. Nexhat Daci, me z. Kolë Berisha, deputet i Kuvendit të Kosovës, si dhe të z. Fatmir Sejdiu me z. Sabri Hamiti, për anëtar të Kryesisë së Kuvendit.

Konstatimet hyrëse:

Në pajtim me kreun 9, pika 1,7 dhe 9 pika 1 dhe 8 të Kornizës Kushtetuese, si dhe të rregullave 4 dhe 5 të Rregullores së punës, Grupi Parlamentar i LDK-së i është drejtuar Kuvendit me propozimin për zëvendësimin e anëtarit të Kryesisë dhe kryetarit të Kuvendit të Kosovës z. Nexhat Daci me z. Kolë Berisha, deputet i Kuvendit të Kosovës, si dhe të z. Fatmir Sejdiu me z. Sabri Hamiti, për anëtar të Kryesisë së Kuvendit. Propozimi u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Lusim kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, prof. Alush Gashi, ta marrë fjalën.

DEPUTETI ALUSH GASHI

I nderuari kryesues, i nderuari z. kryetar i Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, zonja dhe zotërinj deputetë, qeveritarë dhe ju mysafirë të çmuar.

Grupi Parlamentar i LDK-së me mbështetje unanime propozon zëvendësimin e z. Nexhat Dacit, kryetar i Kuvendit të Kosovës me z. Kolë Berisha, deputet dhe nënkryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, si dhe propozon zotri Sabri Hamitin deputet nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës për anëtar të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, pasi z. Fatmir Sejdiu, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës është zgjedhur kryetar i Kosovës dhe me vullnetin e tij ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Kosovës.

Z. kryesues me këtë rast ju informoj se që nga 9 marsi 2006 Ali Sadriu është deputet dhe anëtar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ju faleminderit.

ANËTARI I KRYESISË NAIM MALOKU

Ju faleminderit profesor. Për fjalë nuk ka të paraqitur. Tani u paraqit z. Jakup Krasniqi, shef i Grupit Parlamentar të PDK-së.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

I nderuari kryesues, zonja dhe zotërinj deputetë. Ne e respektojmë vullnetin e partisë më të madhe parlamentare, por jemi të detyruar si grup parlamentar ta bëjmë një pyetje. I përmendi disa pika dhe nene kryesuesi, por në Rregulloren e punës së këtij kuvendi në kreun e tretë ku bëhet fjalë për Kryesinë, rregulla e 5 në

pikën 3 shkruan: “Kryetari i Kuvendit mund t’i paraqesë dorëheqjen Kuvendit, aktin e dorëheqjes me shkrim ia dorëzon paraprakisht Kryesisë së Kuvendit. Pas miratimit të dorëheqjes partia politike ose koalicioni që e ka emëruar ish- kryetarin e Kuvendit propozon kandidatin për kryetar në pajtim me rregullën 4 të kësaj Rregulloreje”. Rregulla 5 pika 5 shkruan: “Shkarkimi i kryetarit të Kuvendit, ose i anëtarit të Kryesisë së Kuvendit,, me propozim të partisë politike , ose të grupit që e ka emëruar, bëhet sipas procedurës së zgjedhjes së tyre”. Në këtë rast dëshirojmë ta respektojmë Rregulloren e punës së Kuvendit apo dëshirojmë ta tejkalojmë këtë rregullore që e kemi miratuar në këtë kuvend.
Ju faleminderit.

ANËTARI I KRYESISË NAIM MALOKU

Ju faleminderit z. deputet. Pika e dytë e rendit të ditës ,që është në shqyrtim tani është zëvendësimi i anëtarit të Kryesisë dhe kryetar i Kuvendit të Kosovës,z. Nexhat Daci me z. Kolë Berisha, pra nuk bëhet fjalë për shkarkim, për zëvendësimin e dy anëtarëve të Kryesisë që janë nga grupi parlamentar më i madh.

Për fjalë është parqitur z. Hajredin Kuçi

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI

Faleminderit z. kryesues, pa dashur të hy në punët në kompetencë të plotë të Grupit Parlamentar të LDK-së, mendoj se ky nocioni “zëvendësim” nuk di ku e keni gjetur në Rregullore ose në Kornizë Kushtetuese. Ju faleminderit.

ANËTARI I KRYESISË NAIM MALOKU

Ju faleminderit z. Kuçi, nuk ka të tjerë të paraqitur për fjalë.
Sipas Kornizës Kushtetuese Kuvendi i miraton këto emërime me anë të një vote formale.

Ftoj deputetët të votojnë për propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Kush është për më duket se është shumica, është votë unanime, ju faleminderit.

A ka kundër 2 vota janë kundër, ju faleminderit.

A ka abstenime 3 abstenime.

Të nderuar deputetë, më lejoni të konstatoj që me shumicën absolute të votave të deputetëve të këtij kuvendi se prezentë janë 107 deputetë, u bë zëvendësimi i dy anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës., që në emër të gjithë juve dhe në emër të Kuvendit të Kosovës ta falënderoj për punën e gjertanishme kryetarin Daci

dhe t'i uroj punë të mbarë kryetarit të porsazgjedhur z. Kolë Berisha. E ftoj ta marrë fjalën.

Z. kryetar, foltorja është juaja.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

I nderuari president dr. Sejdiu, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të korit diplomatik të akredituar në Kosovë, të organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, që tash e 5 vjet po e përcillni me korrektësi dhe po i ndihmoni punën dhe demokratizimin e tij. Të nderuar përfaqësues të Shërbimit Policor, të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, të mediave, zonja dhe zotërinj, kolegë të nderuar deputetë. Jam i vetëdijshëm se duke më dhënë besimin që prej sot t'i organizoj, t'i mbikëqyr dhe t'i koordinoj dhe drejtoj punimet dhe aktivitete e tjera nga fushëveprimi i këtij parlamenti. Në fakt me votën tuaj sot më keni ngarkuar me një obligim të madh, me një detyrë që kërkon mund, përgjegjësi dhe sakrificë. Të nderuar të pranishëm, Kosova ndodhet në muajt dhe në ditët vendimtare, do të thosha edhe para orëve të saj po ashtu vendimtare. Ne tash kemi hyrë në një fazë gjithësi historike për Kosovën, për institucionet e saj të dala nga vota e lirë e qytetarëve, popullin - vullnetin e të cilit ne së bashku, por edhe me ndihmën mendimin e miqve tanë të shumtë të prirë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Bashkimit Evropian, duhet ta çojmë deri në fund, deri në krijimin e një shteti të pavarur dhe sovran, që do të jetë shembull në këtë pjesë të Evropës Juglindore, të një shteti që do t'i bashkëngjitet Evropës demokratike, por gjithësi të një shteti që do të jetë në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, aleatin tonë më të madh që dy herë vetëm brenda një shekulli, në çastet më të vështira u gjend afër nesh.

Zonja dhe zotërinj para këtij Kuvendi, si njërin ndër mekanizmat më të rëndësishëm, në mos më i rëndësishmi për bërjen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran, shtrohen detyra shumë të mëdha, prandaj në këto momente nëpër të cilat po kalojmë edhe mbi partinë time të madhe dhe mbi partitë tuaja pak a shumë më të vogla në numër, është diçka shumë më e madhe, shumë më e shtrenjtë, diçka që duhet të jetë mbipartiake, mbipersonale, mbigrupore, mbikonfesionale, mbigjinore etj-është kauza jonë e përbashkët dhe e përgjithshme- Kosova shtet sovran dhe i pavarur, e tanishmja dhe e ardhmja e fëmijëve tanë dhe e fëmijëve të fëmijëve tanë.

Të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj, ju garantoj se me tërë qenien time do të angazhohem që kjo shtëpi e shenjtë, prej nga dolën dhe do të dalin aktet që përcaktojnë, rregullojnë dhe sanksionojnë sistemin politik, juridik, ekonomik dhe fushat e tjera të jetës në shtetin e Kosovës, të jetë vërtet tempull i demokracisë parlamentare, të jetë tempull i fjalës së lirë të deputetit, të jetë zë i fuqishëm i pozitës dhe i opozitës, i shumicës dhe i pakicës, pra të drejtat e barabarta të të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim etnie, politike, gjinie, feje etj. Do të

angazhohem që deputeti të ndihet zot i vërtetë i kësaj shtëpie. Mua do të më duhet ndihma juaj, por ju garantoj se do ta keni ndihmën time.

Kolegë të nderuar, duke qenë njeriu i parë ndër të barabartit në këtë shtëpi, krahas përpjekjeve të pandërprera për krijimin e kushteve më të mira për punë normale dhe për zgjidhjen e problemeve eventuale të secilit deputet veç e veç dhe të të gjithëve së bashku, natyrisht për aq sa lejojnë rrethanat aktuale, do të angazhohem maksimalisht që në Kryesinë e Kuvendit, përmes grupeve parlamentare, të komisioneve dhe trupave të tjerë të Kuvendit të Kosovës, të thellohet edhe më shumë ajo që për mua është më e rëndësishmja .Do të thosha kushti thelbësor për arritjen e këtyre synimeve janë : toleranca, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi, sepse vetëm kështu mendoj se duhet të shkojmë përpara. Unë mendoj se rruga më e mirë për t'i arritur këta dhe objektivat e tjerë, është zbatimi me përpikëri i Kushtetutës, i ligjeve dhe i akteve të tjera nënligjore, duke përfshirë këtu në radhë të parë Rregulloren e këtij kuvendi. Popujt e civilizuar udhëhiqen nga normat e shkruara, por ne do të dimë të dëshmojmë se jemi të tillë.

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës, më lejoni që në emrin tuaj dhe timin ta falënderoj me këtë rast kryetarin e deritashëm të Kuvendit të Kosovës, akademik Nexhat Dacin ,për punën dhe kontributin e dhënë në udhëheqjen e këtij tempulli të shenjtë të demokracisë në çastet më të vështira për Kosovën dhe për popullin e saj.

Falënderoj partinë time, LDK-n, për besimin e dhënë.. Lehtë nuk do ta kemi, por bashkërisht do t'ia dalim. Jam i bindur se miqtë tanë në radhë të parë ata nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Evropën, do të na ndihmojnë dhe na kanë ndihmuar deri më sot. Amerika dhe Evropa janë këtu për të na ndihmuar që edhe ne të bëhemi pjesë e këtij civilizimi. I garantojmë miqtë tanë se ky është edhe qëllim ynë i përhershëm. Zonja dhe zotërinj edhe një herë ju garantoj për besimin e dhënë.

Ju faleminderit.

ANËTARI I KRYESISË NAIM MALOKU

Faleminderit z. kryetar, ftoj deputetët që seancën ta vazhdojmë në orën 12, anëtarët e Kryesisë i ftoj në një takim me kryetarin e Kuvendit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ashtu si thamë në fillim, pika e tretë e rendit të ditës është zgjedhja e kryeministrit dhe e Qeverisë së Kosovës. Në pajtim me kreun IX, pika 2, pika 4 b dhe pika 9.3.8 të Kornizës Kushtetuese, ftoj kryetarin e Kosovës z. Fatmir Sejdiu që para deputetëve ta paraqesë propozimin e kandidati për kryeministër të Kosovës.

KRYETARI I KOSOVËS, FATMIR SEJDIU

I nderuari z. kryetar i Kuvendit Kolë Berisha, të nderuar deputetë, kam nderin që duke shfrytëzuar dispozitat kushtetuese, para jush sikur se edhe e kam dërguar shkresën zyrtare, ta paraqes propozimin tim, që për mandatar të Qeverisë së re të Kosovës ta caktoj z. Agim Çeku.

Z. Çeku sipas vendimit, po ashtu, ka zhvilluar konsulta të nevojshme me partitë politike të koalicionit dhe partnerë të tjerë dhe e ka hartuar propozimin konkret para jush. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit. z. kryetar, ftoj kandidatin e propozuar për kryeministër të Kosovës z. Agim Çeku që ta paraqesë listën e kabinetit qeveritar. Urdhëroni.

KRYEMINISTRI, AGIM ÇEKU

I nderuari kryetar i Kosovës, i nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar deputetë, të nderuar të pranishëm.

Në bazë të Kornizës Kushtetuese të Kosovës dhe të mandatit të dhënë nga presidenti i Kosovës, pas konsultimeve të nevojshme me partnerët e koalicionit qeveritar, më lejoni ta prezantoj kabinetin e Qeverisë së Kosovës.

Z. Lutfi Haziri, zëvendëskryeministër i Kosovës dhe ministër i administrimit i pushtetit lokal.

Z. Haki Shatri, ministër i Ekonomisë dhe Financave,
Z. Fatmir Rexhepi, ministër i Punëve të Brendshme,
Z. Jonuz Salihaj, ministër i Drejtësisë,
Zonjusha Melihate Tërmkollli, ministre e Shërbimeve Publike,
Z. Ethem Çeku, ministër i Energjisë dhe i Minierave,
Z. Agim Veliu, ministër i Arsimit, Shkencës dhe i Teknologjisë,
Z. Slavisha Petkoviq, ministër i Kthimit dhe i Komuniteteve,

Z. Sadik Idriz, ministër i Shëndetësisë,
 Z. Bujar Dugolli, ministër i Tregtisë dhe i Industrisë,
 Z. Qemajl Ahmeti, ministër i Transportit dhe i Telekomunikacionit,
 Z. Adrian Gjini, ministër i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor,
 Z. Ibrahim Selmanaj, ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale,
 Z. Astrit Haraqia, ministër i Kulturës, Sportit dhe i Çështjeve Rezidente,
 Z. Tomë Hajdaraj, zëvendësministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe i Zhvillimit Rural,
 Z. Aziz Zila, zëvendësministër i Pushtetit Lokal,
 Z. Behxhet Brajshori, zëvendësministër i Ekonomisë dhe i Financave,
 Z. Blerim Kuçi, zëvendësministër i Punëve të Brendshme,
 Z. Dejan Jankoviq, zëvendësministër i dytë i Punëve të Brendshme,
 Z. Mark Komoni, zëvendësministër i Shërbimeve Publike,
 Z. Sylë Hoxha, zëvendësministër i Drejtësisë,
 Z. Agron Dida, zëvendësministër i Energjisë dhe i Minierave,
 Z. Fevzi Berisha, zëvendësministër i Arsimit Shkencës dhe i Teknologjisë,
 Z. Nazmi Fejza dhe z. Ibush Bajrami, zëvendësministra për Kthim dhe Komunitete,
 Z. Fadil Kryeziu zëvendësministër i Shëndetësisë,
 Z. Kadri Kryeziu, zëvendësministër i Tregtisë dhe i Industrisë,
 Z. Blerim Baruti, zëvendësministër i Transportit dhe i Komunikacionit,
 Z. Merxhan Abdyli, zëvendësministër i Ambientit dhe i Planifikimit Hapësinor,
 Z. Lulzim Leci, zëvendësministër i Punës dhe i Çështjes Sociale,
 Zonja Anxhelina Krasniqi dhe z. Eugen Koruglu zëvendësministra të Kulturës, Sportit dhe të Çështjeve Jorezidente.

E vërejtët se vendi i ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe ai zëvendësministrit të Pushtetit Lokal, janë të paplotësuara, sepse sipas Kornizës Kushtetuese janë të rezervuara për Listën Serbe gjithashtu, zëvendësministri i Drejtësisë është vend i rezervuar për Partinë Demokratike Turke. Partnerët e koalicionit ende nuk janë të gatshëm të propozojnë emra, por në afat të shkurtër kanë premtuar se do t'i propozojnë emrat për këto vende në kabinetin qeveritar.

Kam pranuar këtë përbërje të Qeverisë të Kosovës, me një marrëveshje të nënshkruar, me partnerët e koalicionit që në një afat kohor do të vlerësohet puna e çdo ministri të Qeverisë së Kosovës dhe në rast vlerësimit negativ do të kërkohet zëvendësimi i ministrit me kandidatë tjetër.

Prandaj ju ftoj të votoni për këtë kabinet të Qeverisë ,duke e bërë këtë thirrje: Zotohem se besimin tuaj do ta shfrytëzojmë për të punuar në të mirën e gjithë qytetarëve të Kosovës, duke bërë tërë atë që kërkohet nga ne dhe për t'i çuar përpara proceset drejtë bërjes së Kosovës shtet të pavarur dhe sovran. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit z. mandatar. Në sallë i kemi 105 deputetë. Hapi debatin rreth propozimit të mandatarit për qeverinë e re. Fillimisht, urdhëroni z. Thaçi.

DEPUTETI HASHIM THAÇI

Fillimisht uroj zgjedhjen për kryetar të Parlamentit z. Kolë Berisha.

Ju uroj sukses dhe punë të mbarë, gjithashtu edhe kolegut Hamiti për anëtar të Kryesisë së Parlamentit. Siguroj se z. Kolë do të ketë bashkëpunimin e sinqertë të opozitës. Besojmë dhe shpresojmë, se do të kemi hapësirë të mjaftueshme demokratike në të ardhmen si opozitë, në mënyrë që me të vërtetë Parlamenti i Kosovës ,duke respektuar edhe të kaluarën e angazhimeve të veta, por në veçanti të ardhmen, të jetë vendi i debatit, vendi i zhvillimit dhe i avancimit të demokracisë në Kosovë.

Prandaj edhe një herë urime dhe sukses z. Kolë Berisha.

Të nderuar deputetë, të nderuar mysafirë, të nderuar të gjithë ju të pranishëm në sallën e Kuvendit të Kosovës.

Kosova është futur në procesin e vendimeve të mëdha politike, por realisht dhe të zhvillimit serioz të botës së vet pluraliste. Zakonisht ndërrimet dhe ndryshimet në politikë janë të nevojshme kur gjërat nuk ecin mirë, por ka ngecje dhe vështirësi ato duhet të kryhen brenda rregullave të demokracisë dhe sipas bazës kushtetuese të një vendi.

Pa dëshirën time dhe të Partisë Demokratike të Kosovës, edhe sot dua të ripërsëris faktin se, që në fillim të formimit të këtij koalicioni qeveritar, kemi shprehur shqetësimin tonë politik dhe qytetar, me argumente si shqetësim dhe rrezik ndaj demokracisë, sigurisë, së ardhmes së statusit politik të vendit dhe të mirëqenies qytetare të kosovarëve. Një vit resht Kosova u qeverisë në mënyrën më të keqe të mundshme. Korrupsioni s'ka të ndalur, aferat, keqpërdorimet u bënë emblema e Qeverisë së koalicionit aktual. Faktet, faktorët dhe aktorët e kësaj së keqeje të Kosovës të ofruara nga opozita demokratike u kuptuan drejt nga opinioni i gjerë publik, nga shoqëria civile, nga pjesa e mendimit të avancuar demokratik të koalicionit aktual, ato u prezantuan drejt nga shumica e mediave dhe tani po vërtetohen gradualisht edhe nga drejtësia vendore dhe ajo ndërkombëtare. Si rezultat i kësaj keq-qeverisjeje sot Kosova është edhe më e varfër, pasiguria sociale është rritur, zhvillimi ekonomik ka shënuar rënie. Privatizimi si proces është privatizuar nga qeveritarët aktualë, papunësia është rritur, mirëqenia e qytetarëve është në rënie të vazhdueshme.

Falë kësaj keqkeqverisjeje mjeku dhe arsimtari kosovar nuk e kanë të sigurt se në fund të muajit mund ta marrin rrogën . Kjo Qeveri nuk tregoi as përkujdesjen më të vogël për diasporën shqiptare. Ata të gjithë në diasporë, qytetarët tanë pa dallim, e dhanë dhe kafshatën e gojës për çlirimin e Kosovës, ndërsa sot nuk u sigurohet as minimumi i vullnetit të mirë, pasiguria për të investuar kapitalin e tyre në vendlindje në Kosovë.

Nuk u lehtësua së paku as udhëtimi i tyre duke lënë të shëtisin korridoreve dhe zyrave të korruptuara gjatë pushimit të tyre në vendlindje. Falë kësaj keqkeqverisjeje dhe jo nga frika e represionit serb përsëri rinia kosovare ia mësyn Perëndimit në rrugën e pashpresë dhe të zhgënjimit. Intelektualët e rinj po ikin , njerëzit nuk po shohin perspektivë. Përkujdesi për veteranët e luftës dhe të punës, pastaj për pensionistët dhe për kategoritë e tjera sociale është më tepër se përbuzës, por shumë i përmendur në fjalorin e qeveritarëve aktualë. Dita e Dëshmorëve nuk u nderua dhe nuk u respektua nga asnjë institucion i koalicionit aktual. Ndodh që pas një viti kryeneçësie qeveritare dhe arrogance, kritikash të shumta, të aferave të pandërprera, dështimesh dhe pakënaqësish ndaj këtij koalicioni qysh tash po flitet për ndërrime.

Të nderuar të pranishëm, në Qeverinë aktuale nuk po ndodhin ndryshime, por po ndodhin ndërrime të imponuara nga politika. U largua i pari i Qeverisë, vullnetshëm me trafikim politik dhe erdhi tjetri. I pari i Qeverisë ka qenë e keqja më e vogël e Qeverisë aktuale. E keqja e madhe ka mbetur, është këtu, udhëheqës i së cilës në muajt e ardhshëm vullnetshëm do të jetë mandatar i parapolitikës i prapaskenës të politikës kosovare. Sot në Kuvendin e Kosovës po tentohet të ndodhë me vetëdije të plotë rilegjitimimi i së keqes së madhe.

Sot mu në situatën politike dhe më sfiduese të jetësimit të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës tentohet të imponohet edhe një riballafaqim apo eksperiment i ri si ofertë i së njëjtës Qeveri me skenar parapolitik dh me aktorë të njëjtë. Por tani janë shtuar edhe disa figura krejt kozmetike që fare pa kompleksin e keqardhjes minimale etike mendojnë të manipulojnë veten dhe të tjerët mbi misionet e tyre dëshpëruese dhe krejt dështuese.

Kosovës dhe qytetarëve të saj, sot nuk është dashur t'u imponohet kjo zgjidhje e paqëndrueshme dhe e rrezikshme. Përbërja qeveritare e imponuar sot është vetëm riciklim i Qeverisë së deridjeshme, e injoruar e përbuzur dhe e thyer nga të gjithë në Kosovë dhe në botë.

Kryeministrit të mëparshëm, dje iu imponua dorëheqja, sot Kosovës nga koalicioni aktual i imponueshëm po i ndodh një aksident tjetër politik me pasoja edhe më të mëdha.

Kryeministri ka ikur, por e keqja dhe turpi qeveritar kanë mbetur këtu, sepse në çdo segment të Qeverisë kosovare, kjo qeveri ka prodhuar vetëm krizë, dëshprim dhe zhgënjim në mesin e të gjithë qytetarëve dhe të miqve ndërkombëtarë. Sot në këtë parlament është dashur të dilnin mendime unike, të mençura dhe të duhura për të ardhmen e vendit si shtet sovran dhe ngritje e politikave të qeveritarëve për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Duke qenë të vetëdijshëm se edhe ne si opozitë kemi bashkëpërgjegjësinë për procesin politik ndaj vendit dhe popullit tonë edhe një herë kërkojmë nga pjesa e përgjegjshme e mendimit demokratik të partnerëve të koalicionit, t'i evitojë të keqen dhe krimin që po legjitimohen në institucionet dhe në Qeverinë në vijim dhe të mos i mbajnë peng vetëm disa individë të ardhmen politike dhe perspektivën e qytetarëve të Kosovës.

Të ofrojnë alternativa të tjera të njerëzve më të aftë dhe më të përgjegjshëm se këta që po na servohen sot Partia Demokratike e Kosovës edhe një herë e rithekson qëndrimin e vet politik të qartë opozitar duke konsideruar më me rëndësi ndërtimin e shtetit dhe jo marrjen e pushtetit, sundimin e ligjit dhe ndërtimin e demokracisë - mbi të gjitha, përkushtimi i PDK-së do të jetë ndërtimi i shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës, me ulësen në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Urojmë që këtij mesazhi t'i bashkëngjitet mendimi i avancuar demokratik dhe i koalicionit aktual dhe të mos ndodhë e keqja që po pretendohet të ndodhë sot në Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit z. Thaçi, për fjalë është paraqitur shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së Gjylnaze Syla

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

Faleminderit, i nderuari z. kryetar Kolë Berisha i nderuari kryetar i Kosovës prof.dr. Fatmir Sejdiu, të nderuar qeveritarë, deputetë të nderuar, z. Agim Çeku, mysafirë të nderuar.

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së së pari ta falënderoj akademikun Nexhat Daci për punën dhe bashkëpunimin me ne grupin parlamentar me të gjithë ju. E falënderojmë për kontributin e tij dhe shpresojmë se së bashku do të vazhdojmë të punojmë edhe më tej.

I urojmë njëkohësisht z. Kolë Berisha dhe i ofrojmë bashkëpunimin tonë edhe më të ngushtë, njëkohësisht duam të falënderojmë kryeministrin Bajram Kosumi për gjithë punën angazhimin dhe kontributin e tij. Më në fund luftojmë që të tregojmë pjekuri politike, unitet për një qëllim të përbashkët në një kohë kaq të rëndësishme dhe të votojmë për Qeverinë e re. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit. E ftoj shefin e Grupin Parlamentar të LDK-së të Kosovës, profesor Alush Gashin të marrë fjalën.

DEPUTETI ALUSH GASHI

I nderuari z. kryetar i Kuvendit.

Grupi Parlamentar i LDK-së të Kosovës e mbështet propozimin e bazuar në Kornizën Kushtetuese të ekselencës së tij kryetarit të Kosovës për mandatar të Qeverisë së re dhe tërë listën e tij në krye me z. Agim Çekun.

Njëkohësisht rikonfirmojmë se si pozitë do të jemi shumë të hapur dhe transparentë, të bëjmë përpjekje maksimale për mbikëqyrjen parlamentare të organeve të Qeverisë.

Z. kryetar më lejoni me këtë rast që t'iu kundërshtojë akuzat që vijnë në adresë të mandatarit, si edhe listën e propozuar për Qeveri nga miqtë tanë dhe nga opozita. Me këtë rast i ftoj edhe të tjerët që t' bashkëngjiten Grupit Parlamentar të LDK-së për zgjedhjen e Qeverisë së re që është një nga shenjat e shëndetit dhe të zhvillimit të institucioneve demokratike të Kosovës nga institucionet e përkohshme vetëqeverisëse në institucionet e përhershme. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit prof. Gashi, fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të PDK, z. Jakup Krasniqi. Urdhëroni z. Krasniqi

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

I nderuari kryetar i Parlamentit, i nderuari kryetar i Kosovës, deputetë dhe mysafirë.

Koha, ky gjykatës i pagabueshëm, i verifikoi një për një vërejtjet dhe konstatimet e Grupit Parlamentar të PDK-së të ngritura që nga seanca e parë e kësaj legjislature të thëna e të argumentuara në seancat në vazhdim për koalicionin qeveritar dhe për institucionet që më vonë dolën prej tij.

Koalicionit, vetëqeverisjes që e ka ushtruar veprimtari në kontinuitet, nuk mund tu përshkruhet asnjë sukses. Këtë e tregojnë edhe zhvillimet e fundit për funksionet më vitale, siç janë ekzekutivi dhe legjislativi i Kosovës, që përveç

tjerash kanë dëmtuar shumë edhe unitetin e popullit në kohën kur vendit dhe qytetarëve u duhet uniteti në vepër për njohjen ndërkombëtare të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës.

Koalicioni do të duhej t'u tregonte Kuvendit e të gjithë qytetarëve të Kosovës pse ndodhën këto ndryshime të rrufeshme, a po bëhen për ndryshime cilësore për dobi të vendit apo për rirreshtime brenda grupeve të interesit në partitë e koalicionit. Cilat janë arsytet e këtyre ndryshimeve të ngutshme?. Koalicioni duhet të tregojë pse edhe për të tretën herë kërkon legjitimin e krimit, të korrupsionit me të njëjtat figura. Ne jemi të bindur se kohë më parë është dashur të ndodhin këso ndryshimesh, por jo kështu tinëzisht, por duke i numëruar të gjitha faktet dhe dëshmitë për shkelje të ligjeve dhe për keqqeverisje të tjera të mjeteve financiare të tatimpaguesve të Kosovës së varfër, që po prodhon sundimtarë të fuqishëm, sundimtarë që nuk po i nënshtrohen ligjit në fuqi, por sundimtarë që bëjnë ligje sipas tekeve të veta. Ata në vend që të përgjigjeshin para drejtësisë, po largohen me biografi avancuese për ngritje pozicionesh në të ardhmen, për rokada shahu. As institucionet e as qytetarët e Kosovës nuk kanë nevojë për to, por kërkojnë ndryshime më të thella e përmbajtësore që i duhen vendit.

Ne, grupi PDK-së, ishim të bindur dhe jemi edhe sot se ishte krijuar një koalicion i paaftë për ta qeverisur vendin me përgjegjësi në momente kthese, ishim të bindur se kabineti i ofruar jo që ishte i paaftë, por kishte dalë nga grupe parapolitike dhe nuk ua ofronte mundësite reale subjekteve në koalicion e veçanërisht të LDK-së. E njëjta gjë po ndodh edhe tani, ndërsa sa i përket AAK-së u pa edhe një herë që nuk ka kapacitete politike për ta qeverisur vendin, këtë e tregon edhe kandidimi i mandatarit për kryeministër nga sfera ushtarake e një trupe profesioniste, ku duhej të përmbyllte një emision që s'e përmbylli dot. Pra vjen nga sfera jopolitike. Kështu, së paku thonë ligjet në fuqi. Mënyra si po afrohen kuadrat e larta udhëheqëse në institucionin e Kosovës tregon për krizë të thellë morale dhe politike brenda partive të koalicionit, apo kjo duhet shikuar edhe si kërkesë për njerëz të dëgjueshëm nga bosët që nuk mund të dalin në skenë e që u duhet sundimi nga prapaskena. Sundimi nga prapaskena zakonisht bëhet për të sunduar krimi dhe korrupsioni.

Kabineti Kosumi nuk ishte i dobët se udhëhiqej nga Bajram Kosumi, por pse Bajram Kosumi kishte trashëguar një kabinet të dobët të përbërë nga ministrat e inkriminuar që vinin nga bota e krimit të organizuar. Ky koalicion, nëse kihet parasysh mënyra si ka qeverisur deri më tani, nuk mund të ofrojë qeverisje të mirë që u duhet Kosovës dhe qytetarëve të saj. Po të kishte në Kosovë përgjegjësi, atë për këto deshtime do të duhej ta merrnin kryearkitektët e këtij koalicioni.

Kabineti që sot po e ofron mandatarin i ri për kryeministër, nuk ka ndryshime përmbajtësore, sepse në esencë është i njëjti i inkriminuar, i korruptuar, shkelës i

ligjeve në fuqi, diferencues në shërbimin civil, si njerëz që profesionalizmin e zëvendësuan me anëtarë të familjeve dhe me njerëz të paafte e të dëgjueshëm. Këto veprime jo vetëm që do ta çojnë në dështim kryeministrin e ri, por do ta vështirësojnë punën profesionale edhe në mandatet e ardhshme në Kosovën e ardhshme të pavarur dhe sovranë. Mandati i ri me këtë kabinet e ka vështirë për të qeverisur vendin. Ne nuk dëshirojmë ta paragjykojmë kandidatin për kryeministër, por me këtë kabinet që ka ofruar ai po e përcakton fatin e vet, por kabinetit të tij tani iu shtuan edhe dezertorët e luftës çlirimtare. Ky nuk do të bëjë gjë tjetër, por vetëm do të bëhet organ për keqqeverisje, për keqpërdorimi të buxhetit, për krimin e organizuar, për korrupsionin dhe shkeljen e ligjeve në fuqi, që ka bërë dhe deri më tani Qeveria e koalicionit. Ne do të dëshironim që Kosova ta kishte një qeveri të përgjegjshme, në kohën kur pritet të njihet shteti i pavarur dhe sovran për të qeverisur mirë dhe me përgjegjësi, por kjo do të ishte edhe në interesin tonë dhe të të gjithë qytetarëve të saj. Interesi i qytetarëve të Kosovës është që në Kosovë të ketë shumë dritë dhe më pak terr, të ketë më shumë zhvillim dhe punësim e jo vendnumërim, më shumë angazhim për ndryshim se krim dhe korrupsion, më shumë edukim dhe arsim të reformuar për gjeneratat e reja se greva të heshtura në arsim, më shumë kujdes për shëndetin e njeriut se vetëvrasje, më shumë ujë për amvisni e mbështetje sociale për nevojtarët, më shumë kujdes për fëmijën dhe për plakun, më shumë kulturë e traditë kombëtare, më shumë ligjësi dhe siguri për qytetarët e Kosovës, më shumë standard më të mirë për jetën e qytetarëve të Kosovës. Me një kabinet tjetër ne do të prisnim ndryshime, kështu si është e shohim vetëm vazhdimin dhe thellimin e të këqijave të njohura parapraakisht. Kosova dhe qytetarët e saj kanë nevojë për ndryshime të thella dhe përmbytësore, kjo që po i afrohet sot Kosovës pa ndryshime të thella dhe as përmbytësore, as që i meriton ajo dhe as qytetarët e saj. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit z. Krasniqi. Ftojme shefin e Grupit Parlamentar të Partisë Ora z. Veton Surroi

DEPUTETI VETON SURROI

Të nderuar kolegë,
Të nderuar zonja dhe zotërinj,
Kryetar Sejdiu,
Kryetar i Kuvendit, Kolë Berisha.

Procesin që e kemi filluar në Shën Valentin ose më parë nuk ishte punë krijimi të dashurisë në këtë Kuvend, por ishte për fillimin e një etape të re në zhvillimin demokratik të vendit.

Ky proces i ri demokratik ,fatmirësisht, në këtë seancë dhe nën udhëheqjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës krijoi një hap të vogël por të rëndësishëm të ecjes demokratike. Uroj për këtë hap. Z. Kolë Berisha i përgëzoi deputetët e LDK-së dhe njëkohësisht e përgëzoi këtë Kuvend, sepse ky është fundi i fundit hapi i të gjithë neve për ta krijuar një Kryesi që do t'i përkiste këtij Kuvendi , jo një kryesi që gjendet mbi këtë Kuvend. Përgëzoi të parin ndër të barabartit dhe i premtoi, në emër të grupit tonë politik, që do të jemi bashkëpunëtorë dhe ndërtues të konsensusit me te.

Çështja e Qeverisë që shtrohet sot do të përpiqemi për te të flasim me tri koncepte themelore simbolizuese. Dua të flas për fjalën, dua të rrëfej për peshoren dhe dua të flas për rrugët, ato që janë të përbashkëta dhe për ato që na ndajnë. Te fjala një ,Qeveri, cilado Qeveri që i prezantohet këtij auditori do të duhej t'i drejtohej me një program qeverisës. Kjo qeveri,që po na premtohet ose po kërkon voton tonë ,nuk e ka hartuar një program, nuk ka program të ri, ndërsa nuk e ka përmend as të vjetrën,që na ofrohet, është një kontratë gojore që ekziston në gojëdhëna, ekziston në format e shitblerjes së tokave në shekujt XVII, XVIII dhe XIX, por jo edhe në qeverisje, mungesa e kontratës dhe mungesa e programit janë mungesë e fjalës, në popull i thonë se i kanë hëngër- fjalët e veta. Nëse nuk keni fjalë të reja për qeverisje, nëse të vjetrat nuk vlejné mbi çfarë baze do ta ndërtojmë kontratën tonë, mbi çfarë baze t'ua japim votën për këtë qeveri. Qeveria e tretë e këtij koalicioni po e kërkon votën tonë, votën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës me heshtje apo me nënkuptim. Pa marrë parasysh performancat e kësaj qeverie për mbi 15 muaj kërkohet të nënkuptojmë se këta njerëz duhet ta udhëheqin Kosovën, Qeverinë e Kosovës. Atëherë kur krijohen marrëdhëniet e të nënkuptuarit në një parlament, në një sistem politik, atëherë dominon dhe sundon shantazhi. Ajo çka po ndodh sot këtu në këtë Kuvend është krijimi i një qeverie të re me shantazh se duhet të mbeten të gjithë këta ministra , përndryshe u kërcnohen partive të tyre, me shantazh se duhet të mbeten sepse partitë nuk kanë njerëz më të mirë, se duhet të mbeten për hir të stabilitetit të Kosovës. Kosova, të gjithë ne, ky parlament dhe të gjitha partitë politike kanë dhënë ditë pas dite, dhe posaçërisht në momentet dramatike provimin e tyre për stabilitet, pse i frikohemi stabilitetit dhe jostabilitetit. Kjo qeveri do të hyjë për fat të keq çoftë si propozim, çoftë si akt i mbyllur në histori si qeveri e shantazhit.

Koncepti i dytë që duhet t'jua paraqes mendimin tim, së paku në analizën siç e shohim këtë çështje, është ai i peshores. Çdo zgjedhje e çdo vendim në jetë janë matje e argumenteve dhe kjo që ne e bëjmë sot është të matim në peshoren tonë të ndërgjegjës politike, morale etj. Interesi i përbërjes së kësaj qeverie është ky tas këtu. Cili është interesi i përbërjes së kësaj qeverie nëse nuk ka program politik. Cili është ai program qeverisës, cili është interesi i kësaj qeverie nëse nuk ndërrohen shumica e ministrave të saj të dëshmuar, të mos i akuzoj me një fjalë më të rënda, të dëshmuar për joefikasitet ose jopërmëshje të detyrave në punë?.

Nëse nuk ka vizion qeverisës, që mund të jetë interesi i kësaj qeverie që po formohet. Interesi i vetëm zonja dhe zotërinj është të qenit në pushtet, është të qenit në Qeveri. Nëse kjo e vërtetë, atëherë deri vonë se interesi i vetëm i të qenunit në pushtet është gëzimi i benefiteve që i krijon ai pushtet, dhe nëse kjo është e vërtetë, këto benefite për fat të keq në muajt e fundit ose në vitet e fundit, të gjithë ne si kosovarë kemi qenë si dëshmitar se janë benefite joligjore, jashtë ligjore, jashtë institucionale, kanë të bëjnë prej veturave të shtrenjta e deri te formimi i fondeve paralele, qoftë individuale, qoftë partiake.

Tasi i dytë e shikon tasin e parë, në tasin e parë të interesit qeverisës është instaluar interesi i të qeverisurit vetëm për hir të qeverisjes dhe ky interes i të qeverisurit vetëm për hir të qeverisjes e ka krijuar, legjitimuar dhe legalizuar tash më kulturën e korrupsionit në shoqërinë tonë. Nuk flasim për fenomenin e korrupsionit flasim për kulturën e korrupsionit në shoqëri si kulturë qeverisëse zonja dhe zotërinj. Ky tas i dytë në peshoren e të menduarit dhe të vendosurit sot është tasi i interesave të qytetarëve të Kosovës, është perspektiva e tyre e prekshme socio ekonomike, është zgjimi i qytetarit çdo ditë, dhe pyetja se çka do të mund të ndryshojë në jetën e tij, në se ndryshon një qeveri nëse ndryshon një Kuvend. Do të japë një indikatorë i cili është anashkaluar apo hesitet por i cili e tregon zhytjen e gjithë ne zonja dhe zotërinj, jo të koalicionit qeverisës të gjithë ne të qytetarëve të Kosovës në një dimension krejt tjetër të veprimit socio ekonomik.

Kosova këtë vit për herë të parë do të hy me deficit buxhetor të projektuar deficit buxhetor i projektuar që mund të ketë qenë 50 milionë euro në fund të vitit të kaluar tash më arritet në 70 deri në 100 milion euro për këtë vit. Në se është kjo e vërtetë nëse trendi ekonomik tregon se në fund të këtij viti do të kemi deficit buxhetorë prej 100 milionë eurosh kjo është goditja dhe mesazhi i drejtpërdrejtë i qytetarëve të Kosovës, kjo është mesazh për arsimtarin, është mesazh për punëtorin e shëndetësisë, për policin, për të gjithë, ata që shfrytëzojnë buxhetin se prej një gjendje ku Qeveria nuk dinte si t'i shpenzonte paratë, që ishte koha e suficitit, po mbërrijmë në një fazë ku nuk ka para, sepse shpenzimet bëhen në shumicën e rasteve me nevojë por në shumë raste po ashtu kockot e nuk ka proces i cili do të krijojë diçka tjetër, nuk ka asnjë as më të voglin ndryshim në perspektivën për punësimin e qytetarëve tonë ndërrohen qeveritë por perspektivat e tyre nuk ndryshon, nuk ndryshon sepse nuk ka ndryshuar interesi i tasit të parë, interesi i tasit të dytë është ai i cili në këtë rast për grupin tonë parlamentar edhe në të gjitha rastet tjera do të jetë kryesor.

Në këtë Kuvend kemi një rrugëtim të përbashkët. Rrugëtimi është pa tjetër drejtë formimit të shtetit të pa varur funksional dhe demokratik, por nëse jemi në një rrugë të përbashkët në një vend dhe disa pika do të na ndahen këto rrugë si po na ndahen sot. Ne nuk mund të jemi pjesë e interesit të tasit të pa, por mund t'ju sugjerojmë që për hir të demokracisë, për hir të presidencës, së krijimit të qeverisë

së përgjegjshme në Kosovë filloni me këto çështje, llogaridhënie e ndërroni Qeverinë por nuk tregoni se çka ka bërë të mirë ose të keqe kjo Qeveri, duhet të jepni një llogari edhe duhet ta shpërblejmë njeriun i cili ka punuar mirë, dhe duhet të shpërblejmë një formë tjetër njeriun që ka punuar keq, si ka ndodhur me ndryshimet në kreun e Kuvendit.

Çështja e dytë- statusi, zonja dhe zotërinj-, nuk është ngurojë për Qeverinë, por status nën udhëheqjen e kryetarit të Kosovës në formën dhe në mënyrë me të cilën jemi pajtuar në këtë Kuvend, do të ketë kush të punojë, do të ketë kush t'i referojë këtij kuvendit dhe në fund, ky kuvend do të merr vendim. Qeveria duhet të merret jo me muret e jashtme të statusit, por me funksionalitetin e brendshëm të kësaj shoqërie, ta marrë formën se si do të ekonomizojë kjo shoqëri, në formën si do të sundojë ligji në këtë shoqëri. Çështjen duhet ta kemi kujdes të gjithë ne. Nuk ekziston imuniteti politik, fakti që njeriu mund të jetë në krye të listës së popullaritetit, nuk do të thotë se do të përfshihet me automatizëm në menaxhim e në qeverisje apo në ndonjë formë tjetër.

Nuk mund , kjo ndoshta do të jetë sfida e këtij kuvendi, nuk mund më ky kuvend të merret me çështjen e qeverisjes ,si një çështje të balanceve dhe nder të arriturat e së kaluarës dhe dëshirave të projektuara qoftë individuale, qoftë grupe për sundim. Çështja themeltare për këtë kuvend është të tregohet se si do të qeveriset mirë Kosova në 12 muajt e ardhshëm, si do të hyjë në një transicion drejt shtetit të pavarur dhe si ai shtet i pavarur duhet të gdhijë me një konsensus të plotë funksionaliteti të demokracisë. Kosova nuk do të jetë pas 12 muajsh shtet funksional, demokratik si shtetet e Evropës Perëndimore, por e ka obligim ndaj vetvetes dhe ndaj qytetarëve të jetë në atë drejtim ,në atë rrugë. Ne sot ,si grup parlamentar, nuk do të votojmë për këtë propozim qeveritar, se këtu na ndahen përkohësisht rrugë dhe po qe se do të vijë periudha kur rrugët na bashkohen me idealin e njëjtë të funksionalitetit demokratik të shtetit tonë, këtu jemi ne për ta ndërtuar konsensusin . Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Në emër të Grupit 6 +, fjalën e ka z. Xhezair Murati

DEPUTETI XHEZAIR MURATI

Poštovani predsedniče Kosova, gospodine novoizabrani predsedniče Skupštine, gospodine mandatare, gospodine Agim Čeku, dragi gosti i drage kolege, Parlamentarna grupa 6+ koja je deo sadašnje koalicije stala je na stranu procena da treba da se rekonstruiše Vlada, kao udarna igla kao važan segment napredka Kosova u godini izazova, u godini rešavanja budućeg statusa, ali je ovo sigurno i prilika da podsetimo na jednu važnu činjenicu. Naime, periodično Savet

Bezbednosti, Savet Evrope, Evropska zajednica veoma često stavlja sebi za zadatak ono što je i do sada bilo pomoć Kosovu, u oformljenju svoga društva i u tome imamo da ne kažem permanentne ocene i procene da ima napredka u kosovskom društvu. Taj napredak sigurni nije pao sa neba, nije ga požnjela jedna ruka, požnjeli su ga građani Kosova, požnjele su ga institucije Kosova, požnjela ga je vladajuća koalicija, ali ga je požnjela i konstruktivna opozicija. Mi kao deo te opozicije, dakle 6+ koju čine politički subjekti Bošnjaka i Turaka, uvidevši izazov koji se pred svima nama nalazi mi pozdravljamo započetu rekonstrukciju Vlade, mi pozdravljamo promene, mi zahvaljujemo onima koji su shvatili da su imali određene propuste, određene poteškoće koji među nama nisu danas, ali koji su do juče bili, dakle ljudski je nezaboraviti udeo svakog od nas, ljudski je dati i primedbu i propust, ali ja ovde hoću da kažem da i ubuduće sigurno nijedno ministarsko mesto u ovoj Vladi nije zacementirano. Niko nema mandat da pored grešaka koje načini, koje eventualno načini, ostane tamo gde netreba da ostane. Mislimo da će organizacione i menadžerske sposobnosti novog mandatara doći do izražaja time što će s vremena na vreme, a tu je dakle i pozicija ali i konstruktivna opozicija, takva mesta biti na neki način signalizirana tako da mi ovom prilikom podržavamo, još jednom naglašavam, promene sa kojima smo započeli i mi smo ubeđeni da ćemo zarad potreba građana Kosova, zarad budućnosti Kosova, zarad budućeg statusa, ali smatramo da ćemo ovaj vađan ispit koji se nalazi pred nama uspešno poloditi uz maksimalne napore i koalicije ali i opozicije, zarad opet naših građana. Mislimo da ćemo kako to nalažu demokratska pravila ovde na ovom mestu da evidentiramo, šta je učinjeno, šta je propušteno i mislim da smo dosada pokazali da možemo sve izazove na uspešan način da savladamo. Budućoj Vladi, odnosno Vladi koju danas biramo zajedno sa svim onim što je izvršeno u rekonstrukciji i što će se možda ako to potrebe iziskuju, želimo mnogo uspeha, mi stojimo kao garant da ćemo uz maksimalne napore uspeti da damo doprinos koji i građani naših zajednica zajedno sa većinskom zajednicom na Kosovu ulažu. Hvala još jednom i želimo vam uspeh!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ftojme përfaqësuesin e Partisë së Drejtësisë, z. Ferid Agani, Grupi Parlamentar për Integrim. Kërkoj falje

DEPUTETI FERID AGANI

I nderuari kryetar i Kosovës,
I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës,
I nderuari mandatar i Qeverisë së Kosovës,
Të nderuar deputetë ,mysafirë të respektuar.

Fillimisht u uroj sukses në punë z. Kolë Berisha, në detyrën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe z. Sabri Hamiti në detyrën e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Grupi Parlamentar për Integrim shpreh gatishmëri për bashkëpunim konstruktiv në përparimin e mëtutjeshëm të proceseve demokratike në Kuvendin e Kosovës. Grupi Parlamentar për Integrim ka qenë i përgatitur që sot të votojë për kabinetin e ri qeveritar në bazë të një programi të mirëfilltë qeveritar që do të japë përgjigje për problemet e shumta të grumbulluara në shoqërinë tonë. Për fat të keq kjo nuk ndodhi.

Të nderuar deputetë Grupi Parlamentar për Integrim konsideron se serioziteti i çështjes dhe fakti se vendoset për personalitete politike, imponon nevojën të merret vendimi në këtë kuvend për votim të fshehtë, në kuti votimi. Këtë mundësi e parasheh rregulla 18 pika 3 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës.

Votimi i fshehtë do të paraqiste garancionin më të mirë për realizimin e vlerave demokratike në Kuvend. Me gjithë respektin e madh për kryetarin e Kosovës dhe për mandatarin e Qeverisë së Kosovës ,njoftoj Kuvendin se në rast se për kabinetin qeveritar vendoset pa shqyrtimin paraprak të programit të Qeverisë së re dhe në rast se për këtë kabinet të ri vendoset pa votim të fshehtë, Grupi Parlamentar për Integrim do të përmbahet nga votimi. Me këtë rast unë propozoj që kjo seancë plenare të vazhdohet në një seancë tjetër, në të cilën do të kishim rast ta shqyrtojmë programin qeveritar të mandatarit të ri. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ftojme z. Bajram Rexhepi ta marrë fjalën

DEPUTETI BAJRAM REXHEPI

I nderuari president Sejdiu,
I nderuari kryetar i Parlamentit
Të nderuar deputetë

Që nga fundi i nëntorit të vitit 2004 deri më sot ,10 mars 2006, kaluan më shumë se 15 muaj të qeverisjes së koalicionit qeveritarë LDK - AAK. Para Kuvendit u paraqitën për të marrë votën 3 mandatarë, me të njëjtin kabinet qeveritar,që me ndryshime minimale përsëritet në të tri qeveritë.

Deri sa për Qeverinë Haradinaj Parlamenti i Kosovës nuk bëri vlerësim të implementimit të programit qeveritar të koalicionit LDK - AAK për arsye të njohura objektive, pa u mbushur 100 ditë, ish- kryeministri Haradinaj dha

dorëheqje nga posti i kryeministrit dhe u dorëzua vullnetarisht në Tribunalin e Hagës. Ky kabinet qeveritar nuk ishte shpresëdhënës për shkak të një kombinimi ku disa ministra ishin pa nivel adekuat arsimit, disa kanë diplomuar në fakultete gjatë mandatit qeveritar, në mungesë e profesionalizmit dheas përvojë menaxhuese.

Këtu e kisha veçuar nga kritika ish kryeministrin Haradinaj dhe dy tre ministra që ishin mjaft aktivë, por megjithatë rezultatet ishim modeste. Edhe pas renies së qeverisë Haradinaj koalicioni LDK - AAK me amanet paraqet para Kuvendit të njëjtin kabinet qeveritar, me pak ndryshime dhe me z. Bajram Kosumi -kandidat për kryeministër.

Kjo qeveri kishte në dispozicion afërsisht 1 vit të dëshmohej për implementimin e programit qeveritar të njëjtë me aktorë po ashtu të njëjtë. Përkundër premtimit asnjëherë nuk ballafaquam në Parlament rezultatet e kësaj qeverie. Do t'i përmend vetëm disa nga dështimet e Qeverisë Kosumi. Paaftësia profesionale dhe politike, me disa përjashtime të vogla, inkriminim në korrupsion dhe në krim ekonomik, jokonsekuenca në realizimin e vendimeve të veta, nepotizëm dhe diferencim politik i shërbyesve civilë në bazë të përkatësisë partiake.

Do t'i përmend edhe disa dështime konkrete, si :decentralizimi me pilot- projektet komunale, edhe pse është harxhuar shumë kohë dhe energji, dështimi në implementimin e standardeve, përveç standardit të tetë të implementuar nga TMK-ja, vërejtjet për këto dështime janë bërë në tri raporte të Këshillit të Sigurimit, sidomos në këtë të fundit.

Keqmenaxhimi i financave publike dhe shpërdorimi flagrant i tyre nga individët e kabinetit qeveritar.

Për pasojë janë thelluar ngecja e zhvillimit ekonomik dhe varfëria. Mashtrime dhe mosrealizim i pjesëve të kontratës kolektive. Vetëizolimi dhe largimi nga projektet dhe nga iniciativat rajonale në kuadër të mekanizmit përcjellës të stabilizim-asocimit dhe paktet e stabilitetit në programet e REBIS-it, që është infrastrukturë rajonale rrugore hekurudhore etj., të programeve të kartës etj. Gjatë tërë kësaj kohe të keqmenaxhimit dhe joefikasitetit qeveritar, kishte sinjale të qarta nga faktori ndërkombëtar dhe nga opozita, se ky mosefikasitet i përcjellë me shumë afera të korrupsionit dhe të veprimeve të tjera të paligjshme, do ta dëmtojë dhe do ta ngadalësojë procesin e definimit të statusit të Kosovës.

Pas gjithë kësaj shtate dhe dorëheqjes së kryeministrit Kosumi, kemi pritur me të drejtë nga koalicioni qeverisës LDK Aleancë dhe 6+ se do të bëjë ndryshime thelbësore në kabinetin qeveritar. Para nesh paraqitet kabineti qeveritar gati i njëjtë, përveç shkarkimit të zëvendëskryeministrit Adem Salihaj dhe të dy

ministrave të dy ministrive të reja, me mandatar të ri z. Agim Çeku. Çka mund të presim nga kjo qeveri me të njëjtin kabinet qeveritar të dështuar për 15 muaj.

Mund të presim vetëm vazhdim të dështimit qeveritar, ngecje të procesit të definimit të statusit final të Kosovës dhe në të gjitha fushat e lartpërmendura. Kush do të jetë humbësi më i madh në këtë qeveri?. Në rend të parë z. Agim Çeku kryemistër që me vetëdije të plotë hyri në aventurë politike, ku koalicioni qeveritar LDK - AAK fillimisht ia lidhen duart me përzgjedhjen e ministrave.

Tash nuk do t'i vlerësohen kredibilitetet e fituara gjatë luftës dhe si komandant i TMK-së, por rezultatet e kësaj qeverie, pra joefikasiteti, korrupsioni etj., me të cilat do të identifikohet edhe kryeministri Çeku. Unë jam i bindur se ky koalicion LDK - Aleancë ka pasur potencial për të propozuar kuadro shumë më të përgatitura, pse nuk ka ndodhur një gjë e tillë, përgjigjën para qytetarëve të Kosovës dhe para Parlamentit duhet ta japë koalicioni qeveritar që njëkohësisht bart edhe përgjegjësinë më të madhe të dështimit të ardhshëm të kësaj qeverie. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit z. Rexhepi. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar ORA, Teuta Sahatçiu

DEPUTETJA TEUTA SAHATÇIU

Ju faleminderit z. kryetar
I nderuari kryetari i Kosovës,
I nderuari kryetar i Kuvendit z. Kolë Berisha
I nderuari z. Agim Çeku,
Të nderuar deputetë dhe Qeveri

Së pari desha t'u uroj z. Kolë Berisha, zgjedhjen në postin e kryetarit të Parlamentit dhe i uroj që Kuvendi të jetë i zhbllokuar dhe të dinamizohet e të demokratizohet në të ardhmen.

Ne si grup parlamentar e kemi përshëndetur emërimin e shpejtë të mandatarit të ri nga kryetari i Kosovës, si një shenjë pjekurie për ta tejkaluar ngecjen në punën e institucioneve.

Dorëheqja e kryeministrit Kosumi, ishte akt i imponuar me qëllim të inicimit të ndryshimeve pozitive, duke menduar se me këtë dorëheqje do të hapej rruga për krijimin e një qeverie të re me njerëz të rinj, me njerëz që do të kenë fuqi t

a udhëheqin Kosovën në procesin negociator deri në pavarësinë e saj, por si u pa i vetmi ndryshim ishte vetëm heqja e kryeministrit dhe e zëvendëskryeministrit dhe vendosja e një njeriu të ri, emri i të cilit nuk është lakuar me afëra dhe vendosjen e tij në një rreth të vjetër, në rreth të dëshmuar si të dështuar. Në këtë qeveri të re janë të njëjtit njerëz të vjetër, të cilëve iu deshten 50 ditë për ta hapur për qarkullim rrugën kryesore që mbush buxhetin e varfër të Kosovës, rrugë që ushqen Kosovën, i siguron rrogat e arsimtarëve, shëndetësisë, policëve, zjarrfikësve dhe të gjithë atyre që marrin rrogë nga buxheti.

Për tri ditë pas hapjes janë inkasuar 1,3 milionë euro. Shtrohet pyetja sa kanë mbetur pa u inkasuar për këto 50 ditë. A thua do të presim tash edhe 100 ditë të reja për t'i treguar sukseset e punës si qeveri e re apo 50 ditë tashmë kanë shkuar në 50 ditët e Hanit të Elezit. Në të njëjtën listë është edhe ministri i suksesit të lartë artistik që llogarit sjelljen e Samanta Foksit që bënë teatër para qytetarëve të Kosovës, me paraqitjen para kamerave, duke e mbrojtur hotelin Unionin si vlerë artistike që ia ka marrë me dhunë AKM-ja, dhe kërkon që populli ta mbrojë. I njëjti i popull që ia ka dhënë votën për të formuar qeveri, me anë të së cilës do ta ketë fuqinë ekzekutive. Në këto paraqitjet teatrale harron se në bordin e AKM-së që shiti Unionin, i ka dy ministra të qeverisë së vet dhe këtë punë të mbrojtjes së vlerave artistike do të mund ta bënte me detyrë zyrtare, duke e penguar me kohë. Të njëjtën skenar, prej të njëjtit regjisor e kemi parë edhe një herë kur ishte udhëheqës komunal në republikën famoze të Gjakovës me pllakate nëpër rrugë për privatizimin e ndërmarrjeve të Gjakovës. Në vend se ta kryente këtë punë me ministrat e partisë së vet në bordin e AKM-së, këto ndërmarrje sot e asaj dite, ndryshken në Gjakovë që është shndërruar në një qytet me ish- industri. A thua edhe sa kësi teatros duhet të durojmë deri sa të kuptojmë se prej tyre nuk ka dobi. Zgjidhja duhet të kërkohej me punë të mirëfilltë, me vizion, me aftësi për ta identifikuar problemin dhe për të kërkuar zgjidhje adekuate pa teatro, aftësi kjo që tashmë shihet qartë se mungon. A thua të sëmurët nga diabeti, që mbetën pa insulin dhe u fajësuan se kanë bërë rezerva dhe kanë shkaktuar mungesë, apo ata që mbetën pa u operuar për shkak se sallat e operacionit nuk kishin anestezi, duhet të besojnë që këta njerëz të njëjtë që i kanë udhëhequr deri më sot, duhet të transformohen a më parë dhe të zgjohen të nesërmen të përgjegjshëm e të ndryshuar A do të besojnë arsimtarët apo pensionistët për arsytetime të njëjta edhe në këtë qeverinë e re, se nuk ka buxhet për rritjen e pagave të tyre nënçmues, përderisa deri sa gazetat kërcasin nga artikujt për blerjen e veturave ekstra luksoze që shtetet me buxhetet shumë miliardësh do të kishin lakmi, apo blerjen e kompjuterëve ekstra të shpejtë që përveç wordit ndonjë herë exellit, sotverit është ma i forti që përdor këto resurse të forta.

A thua edhe në këtë mandat nënat gjakovare do t'i kërkojnë më të dashurit e tyre dhe duhet të bredhin rrugëve edhe në ditët kur çdokush feston ato t'i çojnë përsëri, por sot nga mospërfillja e institucioneve.

Në këtë listë të Qeverisë ,përveç që nuk ka ndryshime ,s'ka ndryshime as te numri i femrave, numri është i njëjtë minimal, a thua edhe në këtë mandat duhet të dëgjojmë arsyetime dhe fajësime të panumërta të tjerëve për dështime. Në këtë përbërje të Qeverisë së kontinuitetit ka njerëz që në dimër i befason bora, në rrugë i befasonjë gropat, në mihje sipërfaqësore i befason shiu e në verë të nxehëtit.

Kuptoj plotësisht se koalicioni nuk pati mundësi të bënte Qeveri më të mirë Këtë e dimë moti dhe tërë kohën e kemi thënë këtë. I vetmi ndryshim është sjellja e një njeriu që nuk pati afera e dështime dhe që duhet të jetë fajtor kujdestar për dështimet e huaja ,që për arsyet më të sinqerta e merr një barrë tejet të rëndë. Kjo barrë do t'i lidh duart dhe do ta detyrojë të dështojë- njeriu që do të duhej të ishte komandant i parë i ushtrisë së Kosovës së pavarur. Prandaj më gjithë respektin për këtë njeri,për j z. Agim nuk mund t'i japim përkrahje kësaj qeverie.

Kryeministrit të ri i dëshirojmë sukses dhe shumë fat,sepse do t'i nevojitet tepër gjatë mandatit të tij.

Sa i përket Grupi për Integrim, ky e paraqiti një mocion që mendojmë se ky mocion duhet të dalë në votim dhe që më gjithë atë ne e përshëndesim shpejtësinë e kryerjes së zgjedhjeve dhe mendojmë se nuk duhet të humb konteksti demokratik dhe që gjatë votimit duhet bazuar në rregullat 18 dhe 31, të shkojmë me një votim të fshehtë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Meqenëse për fjalë janë paraqitur shumë kandidatë, pas pauzës- pauza- do të jetë deri në orën 2.

/ Vazhdimi i Séancës plenare pas pauzës në orën 15,00/

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Mendoj se kemi pushuar mjaft dhe mund të fillojmë me punë.

Ftojme z. Demir Lima që është paraqitur për fjalë.

DEPUTETI DEMIR LIMA

I nderuar z. Kryetar, të nderuar deputetë dhe mysafirë në sallë.

Unë do të ndalem vetëm te mandatarin e ri për kryeministër z. gjeneral Çeku që për herë të fundit do ta quaj gjeneral. Juve ju besua për të udhëhequr me trupat

mbrojtëse të Kosovës, mision ky për jetësimin e amanetit të dëshmorëve dhe të rënëve për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, për bërjen e ushtrisë së Kosovës. Në momentet vendimtare për Kosovën dhe të ardhmen e trupave mbrojtëse të Kosovës ndërpretë rrugën dhe misionin e nisur për transformimin e TMK-së në ushtri të Kosovës. Ky është një zhgënjim i madh për këtë institucion dhe zhgënjim i madh i qytetarëve që të besuan Ty si gjeneral i TMK-së. Dua t'ju përkujtoj në fund se ushtarët që janë në institucionin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe që ju në momentet vendimtare ua kthyet shpinën, ata nuk do të thyhen sepse ata edhe pa ju filluan çlirimin e Kosovës, edhe pa juve do ta realizojnë misionin e tyre për bërjen e Ushtrisë së Kosovës dhe ne do t'i përkrahim. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Ju faleminderit z. Limaj, për fjalë është paraqitur Berat Luzha

DEPUTETI BEREAT LUZHA

Të nderuar kolegë deputetë, i nderuari kryetar.

Nuk ka dilemë kjo të konstatojmë se kjo Qeveri është e njëjta, ajo që është formuar para 15 muajve më 3 dhjetor 2004. Që nga formimi i saj e deri më sot nuk ka dhënë raport për punën e saj, as raporte 100 ditëshe e as raporte periodike dhe as raport vjetor. Kurse ajo për herë të tretë kërkon votën e Kuvendit në mënyrë që të keqëqeverisë edhe më tutje me të njëjtin tempo. Pos kësaj, sot duhet të zgjidhet edhe kryeministri i tretë me radhë i kësaj Qeverie të pa fat e të pa hair, e ky kryeministër tash na thotë se ka bërë marrëveshje me koalicionin për matjen e punës së kabinetit pas 100 ditëve. Por Kosova nuk ka kohë që të humbë edhe 100 ditë të tjera kur proceset janë shumë delikate dhe ato duhet të zhvillohen shpejt dhe me efikasitet. A nuk ju duket se mjaft është eksperimentuar me Kosovën. Është e habitshme ndoshta kjo mani e jona kombëtare se vrapojmë shumë pas pozitave. Edhe kryetari i parë i kësaj Qeverie, edhe i dyti, por edhe ky i treti kanë vrapuar sa kanë mundur për ta zënë një karrige pa i menduar pasojat që mund t'i kenë si ata personalisht, po ashtu edhe çështja jonë. Madje, kryeministri i ri duhet të merrte mësim nga paraardhësi i tij Bajram Kosumi, i cili edhe pse doli nga vetja e tij d.m.th u tjetërsua krejtësisht, u dogj si është më keq, ky dështim e pret sipas të gjitha gjasave edhe kryeministrin e ri, i cili ka harruar misionin e tij fisnik -bërjen e Ushtrisë së Kosovës. Më shumë se kaq nuk kishim kërkuar prej tij.

Deputetja Sahatqiu theksoi problemin e rrugës së bllokuar në Kaçanik. Ajo tha se rruga është hapur pas 50 ditëve. I kërkoj fjalje asaj, por rruga nuk është hapur ende. Rreziku i shembjes ekziston ende, ashtu siç ka ekzistuar 50 ditë me radhë. Është e çuditshme se si rruga mund të mbyllet 12 orë në ditë dhe 12 orë të tjera të jetë e hapur. Kjo i përngjet asaj formulës së KEK-ut një me një. Unë nuk kam dëgjuar ndonjëherë një rast të këtillë, si qenka e mundur që rruga të jetë e

rrezikshme vetëm natën, kurse mos të jetë e rrezikshme ditën. Del sikur Qeveria ka bërë kontratë me kodër që ajo nëse e ka ndërmend të shembet të shembet natën dhe jo ditën. Si nuk ndjeu asnjë përgjegjësi kjo qeveri për mbylljen 50 ditëshe të kësaj rruge, e cila gjysmë e mbyllur është edhe sot që Kosovës i ka kushtuar mbi 50 milion euro. Si ndjeu përgjegjësi për humbjen e dy jetëve, shkak i mbylljes dhe i moshapjes me kohë të rrugës, të një plaku dhe të një fëmije foshnjë. Si nuk ndjeu përgjegjësi Qeveria për bllokimin e 15.000 banorëve për 50 ditë me radhë, pa treguar për ta asnjë kujdes. Si ndjeu përgjegjësi për keqmenaxhimin e këtij problemi, për malverzimet që i janë bërë për orientimin e biznesit kosovar nga Serbia, e cila fitoi jo pak nga kjo fatkeqësi e jona. Kjo Qeveri hyn në fazën e tretë të ekzistencës së saj me këtë problem shumë të thjeshtë, për ne deri më tash i pazgjidhshëm. Do ta pyesja Qeverinë dhe kryeministrin, kur do ta komunikojë lajmin fatlum se kjo rrugë jetike për Kosovën do të jetë e hapur 24 orë dhe do të jetë e parrezikshme për jetën tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Ju faleminderit, fjalën e ka z. Hajredin Hyseni, kurse le të prëgaditet z. Gjergj Dedaj.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI

Të nderuar deputetë, z. kryetar.

Kam menduar se pas luftës në Kosovë do të futen praktika parlamentare dhe demokratike si nevojë për të krijuar shtetin që aq shumë e dëshiron populli dhe të gjithë ata që e kanë dhënë jetën për të, por demokracia në Kosovë është aq larg na realiteti sa është vërtet shumë zhgënjyese, e sidomos me zhvillimet e tanishme. Të nderuar deputetë, Qeveria e mëparshme edhe pse ka qenë më e dobëta në rajon, kryeministri i saj së paku në shtëpinë e vet ka folur dhe menduar shqip. Isha i mashtruar se Kosovën do ta udhëhiqnin njerëz që do të jepnin gjithçka nga vetja që të realizohen qëllimet kombëtare, por në Kosovë qëllim dhe synim i disa njerëzve është vetëm karrigia, duke shkelur mbi gjakun edhe të bashkëluftëtarëve edhe të gjithë atyre që kanë bërë mund dhe sakrifica. Në Kosovë është duke u instaluar një qeverisje ku punën e vet e bazon në shkeljen e ligjeve dhe në qoftë se e bëjmë një bashkëdyzim në mes punës së ministrave aktual dhe të asaj që po vjen në këtë Qeveri, do të mund ta quanim një Qeveri e Huntës dhe një qeveri mafioze. Kosova me këta njerëz nuk do të mund të prosperojë, nuk do të mund që ta zë hapin në këtë kohë të zhvillimeve të shpejta. Qytetarët dhe të zgjedhurit duhet që të vetëdijesohen për krizën morale që po instalohet sot në Kosovë. Kosovës i duhen njerëz të ndershëm, udhëheqës që jetojnë në Kosovë që edhe familjet e tyre t'i ndajnë këto që po ia gatuan kjo Qeveri, e jo kryeministra që bëjnë eksperimente me Kosovën, ndërsa familjet i kanë në një vend tjetër. Kosovës me

këto veprime po i shkruhet një e ardhshme e keqe, një e ardhme shqetësuese që domosdo duhet ndalur në qoftë se vërtet e duam Kosovën.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BEREISHA

Ju faleminderit z. deputet. Për fjalë është paraqitur Gjergj Dedaj, kurse le të përgaditet Nazim Jashari.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ

Megjithatë, dua t'i them disa fjalë. Në radhë të parë përshëndes z. Kryetar të Kuvendit z. Berisha, z. Çeku, mysafirët që janë këtu dhe flas në emër të Partisë Liberale të Kosovës dhe mbështes plotësisht qëndrimin e shefit të Grupit parlamentar "Për integrim" dr. Aganit. Si parti që jemi të anëtarësuar në disa struktura politike të Evropës dhe të botës, dy gjëra i kam mësuar për këto 15 vite që janë substanciale dhe esenciale për demokracinë. Nëse një personalitet, një faktor, një kandidat dëshiron të kandidohet që të zgjidhet në një forum, në një trup, në një mekanizëm siç është rasti tash në krye të Qeverisë së Kosovës, paraprakisht duhet atij trupi që e voton, që e zgjedh, atij elektorati t'ia paraqet një program se çka do të bëjë për të gjitha këto probleme të grumbulluara për të cilat është debatuar edhe sot dhe që janë evidente në qeverinë aktuale të Kosovës. Ne nuk dimë për asnjë pikë dhe nuk na është ofruar asgjë nga mandatarit për të cilin kemi shumë respekt z. Çeku se çka do të bëjë me këto probleme dhe si të tillë neve na ka vu në një sprovë që ka qenë plotësisht e panevojshme. Po ashtu mbështes idenë që zgjedhja e mandatarit, d.m.th e kryeministrit të ri të shtyhet deri sa ai nuk na paraqet një program konkret. Nuk rregullohet avioni i prishur nëse e ndërron pilotin, por duhet të rregullohen motorët që u janë prishur. Për këtë arsye duhet të na tregojë konkretisht se çka do të ofrojë me një program konkret dhe çështja tjetër është se në demokracinë parlamentare kurrë nuk kam parë se votimi bëhet i hapur. Nëse dëshirojmë një demokraci parlamentare ta instalojmë edhe në shoqërinë e Kosovës, unë e thash edhe një herë dhe kërkoj që votimi të jetë sekret, i mbyllur dhe në mënyrë demokratike të gjithë deputetët pa ngarkesa, pa imponime, pa presione të deklarohen "për" ose "kundër" dhe ai rezultat do të jetë valid, legjitim, do të jetë një mbështetje e mandatarit, respektivisht e z. Çeku. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Fjalën e ka Nazim Jashari, kurse le të përgatitet Sokol Bashota.

DEPUTETI NAZIM JASHARI

I nderuari z. kryetar i Kuvendit, urime për detyrën, i nderuari z. Mandatar, të nderuar kolegë deputetë,

Nuk është bërë zakon që deputetët të flasin nga kjo foltore, e di këtë, por është e udhës që kjo foltore të shërbej për qëllime që është vendosur këtu. Në rast se kemi vërejtje procedurale mund t'i bëjmë nga vendi, por fjalën duhet ta mbajmë nga kjo foltore sepse të gjithë jemi të barabartë në këtë institucion.

Diçka që desha ta tërheq vërejtjen, kolegë deputetë. Dua të them se unë nuk jam pro kësaj qeverie. E kam thënë edhe publikisht, por në asnjë mënyrë nuk jam që të fyhet integriteti moral as i mandatarit z. Çeku, e as i familjes së tij. Ju kisha lutur për konsiderata për njerëzit dhe për asnjërin prej ministrave që janë këtu, pavarësisht që punën e tyre po e gjejnë sot këtu, e jo punën e gjeneralit. Prandaj unë pa e shpreh fjalën distancim, sepse ajo nuk ka kuptim, por e shprehi pakënaqësinë time me mënyrën e qasjes që disa kolegë po e kanë ndaj integritetit personal dhe familjar të njeriut që kandidon për kryeministër. Ju kisha lutur për më shumë konsideratë, për më shumë ta quaj ashtu, ndjesi njerëzore.

Ideja që desha të flas këtu e që realisht më ka destabilizuar ka të bëjë me faktin se është vështirë të fliten fjalë të mira për këtë Qeveri, por pas fjalëve që i dëgjova këtu po e kam problem t'i flas fjalët që e kam menduar t'i flas. Po e kam problem sepse sulmi ndaj integritetit të njeriut është një veprim i cili të destabilizon. Unë jam politikan dhe konsideroj që të gjithë ne duhet të sillemi në suaza politike dhe ajo nënkupton kritika ndaj punës, ndaj veprës e jo ndaj integritetit të njeriut. Këtij koalicioni qeveritar dhe këtyre dy partive që e formojnë këtë koalicion qeveritar, duke qenë se Kosova ende nuk është vend i pranuar në Bashkësinë

Ndërkombëtare, nuk i ka as simbolet e veta, do t'i kishte shkuar më së miri flamuri me shkronjën K në të, sepse me fjalën K fillon fjala Kosovë, me shkronjën K fillon edhe fjala Kuvend. Fjala Qeveri nuk fillon me shkronjën K, por në disa dialekte tona shpeshherë bëhet kjo, kështu që mund t'i themi edhe Keveri,

/ ndërhyrje e kryetarit/ z. Jashari, ju lutem të jeni racional, urdhëroni!

Me shkronjën K fillon edhe fjala Koalicion, i cili po e bën këtë Qeveri dhe, të nderuar kolegë deputetë, ky koalicion po e prodhon edhe një qeveri me një mandatar në krye, një gjeneral të respektuar, e i cili i ka pas veti edhe disa ushtarë shumë të shkretë. Këtë po e them në bazë të asaj që e kanë dëshmuar në beteja, e jo në bazë të diçkahes që nuk e dimë. Këta janë ministra që një vit e gjysmë, mandatarin për kryeministër nuk është, kështu që kualitetet e tij nuk mund t'i vejmë në dyshim. Ato do t'i shohim tek më pastaj, mirëpo ministrave një nga një ua dimë kualitetet dhe kryesisht nëpër resorët që i udhëheqin këta mund të simbolizohet me shkronjën K. Katastrofë është gjendja elektro-energjetike, thua se jemi në 99 apo 2000, energjia është askund, kemi probleme që 7 vite, vetëm se tash është një punë shumë e mirë, sepse shumica e familjeve tona kanë bërë gjenerator, kështu që Kosova është me rrymë gjithqysh. Me shkronjën K fillon fjala krizë, krizë në arsim, krizë në shëndetësi dhe jo krizë e vogël, zonja dhe zotërinj, por krizë shumë e madhe. Për arsimin s'kemi çka flasim, sepse kemi këtu shumë punëtorë arsimorë që e dinë më mirë se sa unë, për shëndetësi u përmendën disa raste, mediumet janë

përplot me afera, mungesa e insulinave, e ilaçeve, por s'kemi çka t'i bëjmë. Me shkronjën K fillon edhe fjala kolaps, kurse në kolaps janë rrugët tona zonja dhe zotërinj, e përmendi kolegja ime Sahatqija, e përmendi edhe z. Berat. Kolapsi në rrugët tona për shkak të gropave dhe me te jemi mësuar, por për shkak të kodrave nuk jemi mësuar, po çka s'po na ndodhë me këtë koalicion. Me shkronjën K fillon edhe fjala kaos. Kaosin e kemi në telekomunikacion, zonja dhe zotërinj.

Telekomunikacionin e kemi në kaos, kryeministri në dorëheqje apo kryeministri i shkarkuar, apo kryeministri që e la punën në parti të vet dhe neve nuk na solli asnjë shkresë për ta dokumentuar dorëheqjen e që është, mendoj, nonsens, sepse z. Haradinaj kur shkoi për Hagë e pruri një shkresë që e informonte Kuvendin që ia kishte dhënë mandatin, se heq dorë nga ushtrimi i detyrës, kurse zoti Kosumi nuk e pa të arsyeshme dhe mbiemri i tij fillon me K. Nuk e pa të arsyeshme që ta bie një shkresë këtu dhe të na njoftojë se tërhiqet nga posti dhe një ditë pa e mbyllur mandatin e tij e nënshkruan njëfarë tenderi se gjoja e ka fituar tenderin dikush që nuk e di unë, një kaos total dhe nuk dua të futem në atë analizë dhe nuk është qëllimi im.

Kurse K-ja më e madhe në atë flamur do të ishte K-ja për fjalën korrupsion, zonja dhe zotërinj. Nuk kemi çka të flasim, sepse është e tepërt të flitet, i kemi ministrat e njohshëm, i njohim, i dimë, ua dimë huqet, e dhëntë zoti që gjenerali t'i fut nën komandë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Faleminderit z. Jashari, mendoj se e ke relaksuar situatën bukur mirë. Fjalën e ka Sokol Bashota, kurse le të përgatitet Hydajet Hyseni.

DEPUTETI SOKOL BASHOTA

Faleminderit z kryetar. Me qenë se është diskutimi im i parë pas zgjedhjes suaj kryetar i Kuvendit të Kosovës, kam edhe një arsye shtesë, mbas votës sime për ju që të uroj zgjedhjen në këtë post dhe për arsyen që jemi vendas. Shpresoj se do të udhëhiqni mirë Parlamentin dhe buxhetin e tij, e jo me stilin alla Nexhat Daci se në radhë të parë kjo do të reflektohej negativisht tek raporti i qytetarëve në Klinë, nga vijmë që të dy ne dhe te klima e dëshirueshme në këtë Kuvend. Kam edhe një shqetësim timin lidhur me mandatarin e Qeverisë z Çeku. Z Çeku, ju kam përcjellë me vëmendje në paraqitjet e juaja publike. Pretendoni të paraqiteni themelues dhe emblemë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por ju zotëri mund të visheni me çfarëdo petku, por jo edhe me petkun e meritave të UÇK-së, se vetëm një muaj keni qenë në radhët e saj zotëri. Nuk jeni sprovuar në asnjë nga betejat e UÇK-së. Gjithashtu, keni dështuar në misionin historik të besuar, e tani jeni futur në kalkulime parapolitike të koalicionit qeveritar të dështuar. Të vetmen të mirë që e keni bërë sot, nëse e keni bërë, është largimi juaj nga TMK-ja, sepse kam bindjen se TMK-ja do të depolitizohet me largimin tuaj e do të ecën drejt objektivave të

saja dhe në harmoni me misionin e saj historik. Ndërsa ju, zotëri të shumicës, këtë që po e bëni nuk është lojë demokratike, t’i shantazhoni ministrat të cilët janë të inkriminuar në krim ekonomik, se do t’i largoni ata mbas 2-3 muajve. Atëherë, pse nuk e bëni këtë sot, apo ju duhet vota e tyre. Kjo është një lojë e ndytë politike që e pëson në kurrizin e tij, në varfëri e në skamje qytetari i Kosovës, prandaj ju kisha lutur që mjaft më me lojëra të tilla. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Ju faleminderit, fjalën e ka Hydajet Hyseni, kurse le të përgatitet Sala Berisha – Shala.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

I nderuari z kryetar i Kuvendit, i nderuari z Çeku, të nderuar kolegë deputetë. Në situata si këto që po kalojmë, zakonisht më sillen në mend lajtmotivi i këngës: “Po kush na ka ngatërruar kaq keq”. Po na ngatërron dikush shumë, shumë keq. E nëse doni për stilistikë, po ta kishim ministrin do ta shpjegonte më mirë. Më falni, këtu qenka ministri i kulturës, ai është në gjendje ndoshta të shkojë më shumë, por po e lëmë për një debat tjetër që mund të jetë publik. Më lejoni, ju lutem, një digresion të shkurtër. Është një urti mbase në Bibël sipas së cilës: “Kush e tundë shpatën nga shpata do ta pësojë” Në një farë mënyre kjo sot i ndodhi z. Nexhat Daci, ai i shkelte shpesh procedurat dhe sot kam përshtypjen se sot e pësoi me shkelje procedurale. Z Nexhat Daci mbase edhe e meritonte këtë, por nuk besoj se e meritonte ky Kuvend, nuk e meritonim as ne deputetët, u vumë në pozitë absurde, u votua jo për dorëheqje, as për shkarkim sipas Rregullores, por për zëvendësim, kurse zëvendësim në praktikën tonë s’ka. Vendi i kryetarit u zu para se të hiqej kryetari i mëparshëm. Unë nuk gjeta zgjidhje tjetër, pos që abstenova. Besoj se do të abstenonin shumica e deputetëve, por të mos ishte mbështjellimi i këtij marifeti me shprehjen: “zëvendësim”. Kjo shkoi dhe unë nuk do të kthehesha prapa, sikur të mos viheshim sërish në pozitë absurde. Tani kërkohet vota jonë për Qeverinë. Rregulla 18 e Rregullores së Kuvendit kërkon që mandatarin t’i paraqesë paraprakisht Kuvendit programin e Qeverisë dhe përbërjen e Qeverisë. Kjo nuk është bërë. Mbetet dilema pse nuk u bë dhe dilema tjetër do të votojmë programin e vjetër të Qeverisë, apo çka. Nuk është e qartë, gjithashtu, nëse do të votojmë Qeveri të re, Qeverinë e vjetër, apo vetëm kryeministrin. Po të votonim mandatarin dhe ta autorizonim atë që të formonte kabinetin qeverisës, besoj se gjithçka do të ishte ndryshe, por kjo nuk u lejua dhe nuk na u tha pse nuk u bë kështu. Nëse duhet të votojmë Qeverinë e vjetër pa Bajram Kosumin e bërë kurban, po të ishte Bajram Kosumi kryeministër, ne sot ose ndonjëherë tjetër të diskutonim për raportin e Qeverisë, apo jo, është edhe obligim kushtetues. Pa Bajram Kosumin ne tani nuk bisedojmë punën e Qeverisë, por duhet të rivotojmë Qeverinë blanko pa asnjë raport. Pse? Bajram Kosumi paska qenë gjithçka në

Qeverinë e mëparshme. Atij i përkisnin të gjitha gjynahet, të gjitha gjykimet. Nuk besoj! Muaj më parë, kolegë të nderuar, në një debat në këtë Kuvend i kisha tërhequr vërejtjen mikut tim Bajram Kosumit se ishte futur në lojë të huaj dhe po merrte në mbrojtje pa asnjë nevojë shkelësit që do të tregoheshin mosmirënjohës dhe ai vërtet i mbronte ata me të gjitha forcat, ndonjëherë edhe duke shkelur mbi shokët e tij më të mirë. Nuk kam dëgjuar dhe nuk po dëgjoj që tani ta marrin në mbrojtje tani kolegët e tij qeveritar. A nuk flet kjo diçka. Bajram Kosumi mbasi në një mënyrë edhe e ka merituar këtë, por nuk besoj se e meriton Kosova. I nderuar z. Agim Çeku, i them këto jo rusisht. Kam respekt për punën, veprën tënde, për njerëzit e profilit tënd, jo vetëm unë, por jam i bindur se edhe shumica dërmuese e deputetëve do të votonin me kënaqësi dhe pa hezitim. Por, është bindja se je futur në lojë të huaj, nuk po bën qeveri të re, por të kanë dhënë detyrë të pamundshme. Të bësh specialitet të ri me gjellë të vjetër, nuk besoj se do të dali mirë. Uroj që të nxjerrësh përfundimet e duhura nga përvoja e Bajram Kosumit dhe nuk ta dëshiroj sinqerisht fatin e tij, “Trimi i mirë me shokë” kështu thonë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Ju faleminderit, fjalën e ka znj. Sala Berisha – Shala, kurse le të përgatitet Hajredin Kuçi.

DEPUTETJA SALA BERISHA – SHALA

I nderuari z. kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, të nderuar deputetë. Është e quditshme se si kjo Qeveri po konstituohet me një kabinet të vjetër dhe atë me ministra të tillë, të cilët jo vetëm që nuk i kanë përmbushur premtimet e dhëna, por edhe vazhdimisht kanë keqëmenagjuar dhe keqpërdorur pozitën e tyre, duke shkelur madje edhe ligjin. Unë do t’i përmend shkurt keqëmenagjimet në fushën në të cilën jam anëtarë e komisionit funksional të cilat i mbulon ky komision disa prej ministrive. P.sh Ministria e Energjetikës dhe Minierave në krye të së cilës është z. Çeku, i cili sapo e mori postin patë premtuar se pas 6 muajsh do ta stabilizojë gjendjen energjetike në Kosovë dhe do ta bëjë dritë. Tani në realitet shohim një kolaps energjetik, terri mbizotëron. Kështu, ministri Çeku nga një premtues drite u shndërrua në ministër që ofron terr në Kosovë. Pastaj ministri i Tregtisë dhe i Industrisë, Dugolli, i cili është edhe anëtar i Bordit të AKM-së, me veprimin e tij në procesin e privatizimit sot ka kallëzim penal në Gjykatën e Lartë për krime të rënda ekonomike, si dhe konflikt interesash në privatizimin e Feronikelit. Pastaj, ministri i Posttelekomunikacionit, të cilit i leverdis më shumë bllokimi i rrugës se sa zhbllokimi i saj, e të tjera keqëmenagjime dhe keqpërdorime që do të ishte mirë t’i dinte mandatarin. Të tëra këto ndryshime që po ndodhin sot në Parlament dhe Qeveri janë bërë jo për t’i qar proceset përpara, por që të sanohet një tërmet që ka ndodhur brenda koalicionit, por edhe brenda pjesëve të atij koalicioni dhe këto sanime përpiqen t’i bëjnë duke legjitimuar parregullsitë,

korrupsionin, shkeljet e anomalitë tjera. Pyes me të drejtë, cili njeri me logjikë të shëndoshë, duke i njohur këto realitete do të vije në krye të një kabineti dhe do të bëhej pjesë e një kabineti të tillë e që sigurisht që do të përfundojë bash si pasardhësit e këtij kabineti qeveritar. Kjo ndoshta do t'i ngjante më tepër një storje loje fëmijësh, të cilët u munduan ta fusin një mollë të shëndoshë, në qoftë se është e shëndoshë në mesin e mollëve të kalbura, duke menduar se do t'i shpëtoj të gjitha të kalburat. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit. Fjalën e ka Hajredin Kuçi, kurse le të përgatitet Fetah Berisha.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI

Faleminderit i nderuari kryetar, zonja dhe zotërinj, të nderuar kolegë deputetë. Do të provoj që shkurtimisht t'i përmend dy çështje kryesore sot. E para, roli si opozitë në kushte të reja në Kosovë dhe e dyta, perceptimin tim, ndoshta edhe të qytetarëve të Kosovës për këto ndryshime në Qeveri. Besoj se të gjithë jemi të vetëdijshëm se të qenët opozitë në vitin e fundit ka qenë një test sa i vështirë në Kosovë. Po e them këtë për tri arsye. E para, ndoshta ka qenë vështërsia e parë me kryeministrin Haradinaj në kohën e ngritjes së aktakuzës së tij dhe mendoj se duke u bazuar në një kod moral kemi qenë sa të përmbajtur për këtë. Çështja e dytë mendoj se ka qenë çështja e sëmundjes së presidentit të ndjerë Rugova, po ashtu në atë kohë besoj që kemi pasur arsye dhe jemi përmbajtur nga vërejtjet, sugjerimet apo alternativat që mund të jepen dhe çështja e tretë për të cilën kemi menduar që nuk do të ndryshoj lehtë ka qenë çështja e statutit të Kosovës. Ndoshta me ndryshimet e fundit në Qeveri po jepet një sinjal i qartë se opozita mund të funksionojë në ndryshimet e një Qeverie pa e dëmtuar procesin e statusit të Kosovës. Lidhur me perceptimet e mia, besoj edhe të shumicës së qytetarëve të Kosovës për ndryshime në Qeveri, do të theksoja se emërimi i z. Agim Çeku si mandatar, për optimistët me siguri për miqtë e tij dhe njerëzit që dëshirojnë një Qeveri efektive dhe cilësore ka qenë një entuziazëm, përfshirë edhe mua. Por, në anën tjetër mendoj se dy çështje ia kanë vështirësuar pak sa punën z. mandatar, e para, duke i ofruar një program të njëjtë, për të cilin mendoj se është krijuar një logjikë mbi bazën e së cilës njerëzit mund të udhëheqin institucionet e Kosovës me programe politike të të tjerëve, pa e ofruar vetë programin politik. Nuk e kam fjalën për qëllim politik, sepse e kam të qartë qëllimin politik të z. Agim, por e kam fjalën për programin e tij politik, ekonomik, social dhe kështu me radhë. Pra, duket se po e merr prej një misioni më të gjerë një program politik të një grupi politik, apo të një partie politike, thënë më qartë. E dyta, mendoj se ia kanë kushtuar punën me strukturën e njëjtë të Qeverisë. Pse po e them këtë. Ndoshta emëruesit e z. Agim Çeku kanë tentuar që t'i japin legjitimitet Qeverisë aktuale, kanë tentuar që t'i japin një lloj autoriteti njerëzve që janë shquar në opinion për

joprofesionalizëm, shpeshherë janë supozuar për inkriminime të ndryshme dhe deri në atë se ata udhëhiqen nga grupe parapolitike. Unë mendoj se në këtë rast z. Çeku do të japë në këtë Qeveri se sa do të marrë në kuptimin e autoritetit. Një çështje tjetër në perceptimin e qytetarëve dhe mendoj se është dilema për TMK-në dhe atë për dy arsye. E para, funksionimi aktual i TMK-së është identifikuar shumë me z Agim Çeku dhe, e dyta, mendoj se në kohën e ristrukturimit të TMK-së, besoj se z. Agim Çeku është i njohur si shumica prej nesh, me siguri se kam dëshirë të supozoj se nuk do të ketë zhvillime negative atje. Një çështje tjetër, mendoj që është hapur në opinion të qenët gjeneral paraprak të z Agim Çekut është menduar se ky do t'i udhëheqë ministrat aktual. Unë do t'ia them një matematikë politike shumë të shkurtër z. Agim Çeku. Unë e di se ju mund të jeni shef i këtyre ministrave, por besoj se edhe ju e dini se edhe këta ministra e kanë edhe nga një shef tjetër politik dhe ai shef tjetër politik në fakt është edhe shef i juaji. Pra, duke qenë shef i tyre, nuk është shumë efektiv. Para se të hyjë në sallë, një mik i yni i përbashkët tha se z. Agim Çeku ka qenë i gatshëm të luaj lojëra në ushtri, e do ta bëjë të njëjtën gjë edhe në politikë. Unë i them z. Agim Çeku se në politikë janë dy vështirësi, e para në ushtri ke qenë profesionist dhe e dyta, në politikë janë disa rregulla tjera. Me fjalë të tjera, mendoj se nga misioni historik që e keni pasur dhe jeni çmuar për punën që keni bërë, jeni tkurrur në një shërbyes të një grupi politik apo parapolitik. Ndoshta në veprime të tilla edhe autoriteti i juaj personal dhe i Qeverisë nuk do të jetë në kuptimin e ngritjes së saj, por në kuptimin e zbehjes së autoriteteve që mund të jenë të dobishme në një fazë tjetër. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Ju faleminderit z Kuçi, fjalën e ka Fetah Berisha, kurse le të përgatitet Selvije Halimi.

DEPUTETI FETAH BERISHA

Zotëri i nderuar kryetar, nuk e kërkoja fjalën për të diskutuar, por desha t'ju rikujtoj se këtu para vetes të gjithë e kemi rendin e ditës të këtij Kuvendi. Tani jemi në pikën e tretë të rendit të ditës dhe në pikën e tretë të rendit të ditës shkruan. Zgjedhja e kryeministrit dhe Qeverisë së Kosovës. Tani ma merr mendja se është rendi që të votojmë e të punojë ky Kuvend sipas rendit të ditës, sepse nuk mund t'i japim z Çekut leksione për të cilin tek tash duhet të votojmë. Kemi kur të vlerësojmë edhe Qeverinë që do ta votojmë tani, por edhe të kaluarën që ka qenë, prandaj ju lutem, z kryetar, të kalojmë në votim edhe të punojë ky Kuvend sipas rendit të ditës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit z. Berisha, është e qartë se flasim për pikën e tretë të rendit të ditës dhe debati është e drejtë e deputetëve.

Ftoj deputeten Sevdije Halimi, kurse le të përgatitet deputetei Mark Krasniqi.

DEPUTETJA SEVDIJE HALIMI

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,

Dhashtë zoti që tash e këndeje ky Kuvend të jetë vërtet Kuvend debatesh dhe të instalojë demokraci nga Kuvendi e gjer në bazë. I nderuari mandatar, ky kabinet qeveritar që ju prezantuat sot në një kohë kur ata bëhen pashallarë dhe niveli apo standardi jetësor i popullatës bie nën zero, kam menduar për një shëndetësi të popullatës dhe ka ndarë vetëm 0.70 cent mjete për barëra për kokë banori. Kjo tregon se sa ky kabinet qeveritar është kujdesur për popullin e vet në emër të të cilit po menagjon dhe po merr mandat pas mandati. I nderuari mandatar, ky kabinet qeveritar për një vit dhe tre muaj ka bërë shkeljen e më tepër se 15 ligjeve të aprovuara në këtë Kuvend që po qe se bëjmë një ndarje për kokë ministri, i bie më shumë se një ligj të shkelur për çdo muaj, për të cilat do të ofrojmë fakte në të ardhmen. Ndoshta nuk e keni ditur, mirëpo me çfarë perdeje ju mbuluan sytë kur ju ofruat para këtij Kuvendi një kabinet qeverisës të tillë, njerëz që thanë se për 15 vite duhet të durojmë në emër të pavarësisë së Kosovës, janë në krye të këtij kabineti qeveritar dhe janë duke udhëhequr me ministrinë. A thua vetëm populli u dashka të durojë në emër të pavarësisë dhe ata të bëhen vërtet pashallarë mbi pashallarë. Unë mendoj se ky është një gabim shumë i madh. Mbetet çështje e prokurorisë që eks-oficio të bëjë ndjekje penale ndaj shkelësve të ligjeve dhe sigurisht që juve pastaj brenda 15 dite do t'ju duhet që çdo ditë të ndërroni nga një ministër. Dhashtë zoti të jetë kështu! Në kohën kur po bisedohet për statut, ky koalicion qeveritar është dashur të mendoj se çfarë mandatar i ofron Qeverisë së Kosovës një mandatar vërtet të Kosovës, apo një mandatar me dy shtetësi. Në çfarë kalkulime ratë dhe si do të qëndroni nesër në negociata, kjo është çështje që ju drejtohet juve si mandatar në të ardhmen, mirëpo kjo është çështje edhe për kabinetin qeveritar që në rolin e ekzekutivit asnjëherë nuk mendoj për Kosovën, as për qytetarët e saj. Le të vazhdojë si ka filluar, por pa ne.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit, fjalën e ka Mark Krasniqi, kurse le të përgatitet për fjalë Nekibe Kelmendi.

DEPUTETI MARK KRASNIQI

Ju faleminderit z kryetar, ju përsëndes të gjithëve që mos të humbim kohë me emra duke përsëndetur, ju përsëndes përzemërsisht dhe ju faleminderit që ma dhatë fjalën.

Kudo në botë parlamentet janë shpeshherë jo parlamente, por edhe Hajt Park, ku mund të flitet gjithçka, madje edhe mirë edhe me vend, por edhe keq dhe jo me shumë vend. Këtu konkretisht akuzohet një mandatar i Kryesisë së Qeverisë për karrierizëm, ka ardhur këtu që të bëjë karrierizëm. Unë nuk di se ku i kanë sytë njerëzit. Deri dje e kemi parë me shumë nishana, gjeneral e sot jemi si unë e si ai, pa asnjë nishan dhe pa asnjë send. Karrierizmi është mbërri në qoftë se ka pasur kush dhe duhet të ketë njëfarë dëshire që të përparojë. Por me ardhjen e z Çeku këtu, ky e ka degraduar në njëfarë mënyre veten, sepse nuk ka kurrfarë nishanesh. Nuk po them vetëm nga pikëpamja vizuale, por edhe nga realiteti. Ai e ka mbërri gradën më të lartë në ushtri. Unë i njoh, ju jeni më të ri dhe nuk i njihni, kurse unë i njoh këto grada, ka mareshal dhe gjeneralsimus. Mareshal e kemi pasur Titon, gjeneralisimus e ka pasur bota Stalinin. As njërin e as tjetrin nuk i duam ne këtu. Mjafton gjeneral. Me ardhjen e z Çeku këtu në Kuvend, Qeveri, njerëzit po e akuzojnë se e ka lëshuar frontin ku e ka pasur vendin. Gjenerali është gjithmonë edhe strateg. Ai e lëshon një front për të shkuar në frontin tjetër ku është lufta më e ashpër. Kështu ka bërë edhe zotëri Çeku këtu, sepse sot është lufta për Kosovën, nuk është lufta për karrika. Disa e donë vetëm karrigen. Të them drejtë, këtu si po flitet gjithçka kundër Qeverisë dhe kundër personave, karrika është në pyetje. Duhet të jemi shumë të sqarë, Kosova është si paravan për disa, por secili e ka moralin e vet, peshën e vet dhe mënyrën e vet të shprehjes. Këtu në këtë front bëhet lufta për Kosovën dhe jo fillimi i luftës, por hapat e parë, zbrazen armët e fundit dhe rezervat e fundit të municionit për pavarësinë e Kosovës. Z. Çeku unë ia uroj këtë guxim që e ka pasur të vijë këtu, por z Çeku për ta shkyer edhe këtë front, ai duhet t'i ketë edhe ushtarët e vet, ushtarët i ka ata që i ka zgjedhur dhe që do t'ia zgjedhim edhe ne ndoshta, por duhet të na ketë edhe ne se jemi në Parlament që dimë shpeshherë vetëm të kritikojmë. Unë mendoj se ky front është front i të gjithë neve dhe ne duhet ta përkrahim edhe kryetarin e Parlamentit dhe kryetarin e Qeverisë edhe kryetarin e Kosovës që ta shkyjmë këtë front sa më parë, ta shkyjmë ashtu si duhet e jo me enklava e s' di çka po kërkohet tjetër që të kemi ne mirëkuptim dhe të lëshojmë pe. Nuk lëshohet pe për një Kosovë të pavarur demokratike dhe multinacionale. Multinacionale në rregull, kemi shumë nacionalitete, por multinacionale atëherë do të ishim të gjitha shtetet e Evropës, ku nuk e bëjnë 90%, rrallë ndonjë shtet përbën 90% të popullsisë në atë shtet, ku mund të jetë një shtet multinacional kur është 90% një popullsi e një kombësie. Por ne jemi, i pranojmë, por vetëm Kosovën ta kemi të pavarur. Unë këtu dëgjova edhe për votimet e mëshehta, votimi i mëshehtë është një mënyrë e demokracisë, është e vërtetë, por është edhe një mënyrë e mospasjes të trimërisë për ta thënë

hapur bindjen tënde me një ngritje dore, të dyja shkojnë krahas. Unë mendoj se këtu të gjithë janë trima dhe do të votojmë ashtu siç duhet sa më parë dhe sa më shpejtë dhe sa më mirë. Unë vetëm edhe njëherë apeloj ta kemi Kosovën parasysht, ta kemi vetëm interesin e Kosovës. ka kohë për karrika. Jeni të gjithë të ri këtu, dikush këtu i ka lyer flokët për t'u dukur më plak, por jeni të gjithë të ri dhe ka kohë që të mbërrini diku, por me punë të ndershme. Pushteti mund të merret vetëm me votën e popullit. Çdo pushtet që merret me dhunë, atë e pret humnera. Ai nuk është pushtet i popullit dhe nuk ka perspektivë. Ne do t'i kemi votimet, votojmë në mënyrë demokratike edhe kush të fitojë, atij t'ia urojmë edhe ta ndihmojmë që të bëjë punë të mbara. Unë në emër të Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës, të cilin e përfaqësoj vetëm unë këtu, ju uroj z. Çekut edhe gjithëve ministrave dhe gjithë pushtetarëve punë të mbarë edhe të frytshme sa më parë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Fjalën e ka z. Nekibe Kelmendi, të përgatitet Enver Hoxhaj, më falni.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI

I nderuari z. parlamentar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar ministra dhe mysafirë të nderuar.

Ne sot këtu po diskutojmë, nuk po diskutojmë për raportin e punës së Qeverisë, ndërkaq që pjesa më e madhe e debatit pikërisht iu adresua raportit të punës së Qeverisë.

Ne sot këtu nuk po diskutojmë as për gjendjen në Kosovë, për këtë nuk u tha asnjë fjalë. Ne sot këtu kemi në rend të ditës zgjedhjen e kryeministrit dhe të kabinetit të tij, përkatësisht të qeverisë. U diskutua se po mungojka programi i Qeverisë dhe duhet të shtyhet për këtë arsye kjo pikë e rendit të ditës, deri sa të paraqitet programi i Qeverisë nga mandatarin e Qeverisë por mos të harrojmë kolegë të nderuar se ne vetë jemi dëshmitarë se për një vit tri here po votohet, kryeministrin dhe Qeverinë. A thua çfarë ka ndryshuar në rrethanat në Kosovë për këtë periudhë kaq të shkurtër duke ia marrë kësaj periudhe edhe kohën e zisë, kohën e pushimeve vjetore për tu paraqitur nevoja e hartimit të një programi tjetër qeveritarë, prandaj le të merret si akceptim nga ana e mandatarit të ri në mënyrë konkludente programi i mëparshëm i Qeverisë dhe të vazhdohet me punën për emërimin e kryeministrit dhe të Qeverisë.

Kolegë deputetë, qeverinë, nuk e ka mandatin ta bëjë opozita, por pozita, prandaj i mbetet opozitës ta votojë, ose të mos e votojë këtë Qeveri, kjo është çështja e sajë por unë ju lus që së paku të kemi një respektim të kodit të mirësjelljes dhe t'i

kursejmë si mandatarin për kryeministër, dhe për formimin e qeverisë së re, nga fyerjet nga shpifjet, nga fjalimet boshe, pa asnjë fjalë pozitive, e deri dje çdo kush ka folur në superlativ për te. Mos harroni se nuk është hera e parë në historinë e ndërtimit të shteteve dhe të themelimit të qeverive që një ushtarak të heq rrobat e ushtarakut dhe të shndërrohet në civil dhe ta merr timonin e Qeverisë në dorë dhe të udhëheqë me qeverinë.

Këtë e ka besimin prej deputetëve të LDK-së ta bëjë pikërisht mandatarin z. Agim Çeku. Këtë debat që për mendimin tim nuk ka qenë dashur të bëhet, jo kësi soji e vlerësojë shumë ulët, dhe me një notë negative, sepse herë sulmohet mandatarin si individë, e herë sulmohet tërë kabineti i tij, kryesorja është që për këtë Qeveri të propozuar të flitet keq, dhe madje edhe me këto akrobacione, si thash herë mandatarin e herë kandidatët për ministra dhe zëvendës ministra. Nuk është rast unikat e thashë edhe më përpara që një gjeneral të transferohet në një person civil. Por unë diskutimin e sotëm këtë e them me sinqeritetin më të madh e kuptoj si tentim për krijimin e një krize institucionale, e kjo me qëllim të krijimit të një qeverie të koalicionit, këtë duhet ta them haptazi të gjithë, ky është synimi i këtij diskutimi, mirëpo këtë nuk e lejon vota, këtë nuk e lejon as koalicioni në mes të AAK-së, LDK-së dhe Grupit 6+ edhe PSHDK-së. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Kemi edhe pak kandidatë, thërras deputetët që të vijnë në sallë, sepse duhet të votojnë, fjalën e ka deputeti Enver Hoxhaj, le të përgatitet për fjalë Gani Koci.

DEPUTETI ENVER HOXHAI

I nderuari z. kryetar,
Të nderuar kolegë.

Mendoj që nuk është qëllimi i askujt këtu, as i Grupit parlamentar të PDK që vërtetë këtë debat ta shndërrojë në një debat moralizues, dhe nuk ma merr mendja fort nevojë për ligjërata moralizuese se çka synohet, cilat janë votat, dhe cila është konstelacioni politik i forcave në këtë Kuvend të Kosovës, dhe kisha bërë thirrje edhe te deputetët e tjerë moralizimet le ti ruajnë për takimet e tjera private, mirëpo mos ta interpretojnë situatën e cila gjendet aktualisht Kosova në një formë shumë selektive.

Dilema të cilën e kemi ne si opozitë dhe parti demokratike është shumë e thjeshtë. Qytetarët e Kosovës sot pyesin se çfarë po ndodhë në këtë seancë të Kuvendit, ata që janë jashtë kësaj seance. Qytetarët e Kosovës pyesin se çfarë ndryshime do të sjellë eventualisht kabineti number 3 i koalicionit qeverisës dhe qytetarët e Kosovës pyesin se çfarë do të thotë një kabinet i tretë mbas 15 muajsh të këtij

koalicioni qeverisës. Përgjigjet janë shumë të thjeshta, kjo nuk do të thotë asgjë. Ndryshimet nuk do të jenë kurrfarë, dhe fjala përmbledhëse është dështim. Kjo është dështim fundamental thelbësor në një kohë kur Kosova ka më së shumti nevojë progres dhe ku jemi në procesin e shtet-ndërtimit.

Në të kaluarën edhe kjo ndërtesë, edhe ky Kuvend i Kosovës edhe qytetarët e Kosovës kanë akuzuar të tjerët dhe kanë fajësuar të tjerët për blerje të kohës dhe për pengesa në përcaktimin e statusit final të Kosovës. Sot kohëblerja dhe pengesat kanë një emërues të përbashkët dhe ky është koalicioni qeverisës dhe partitë të cilat e formojnë LDK dhe AAK-ja.

Rrënja e Qeverisë së Kosumit është perceptuar në jetën tonë publike si një lajm i mirë me shpresën që do të kemi ndryshime në qeverisjen e Kosovës. Ne si parti demokratike e kemi cilësuar që nga fillimi dhe e tillë doli që Qeveria Kosumi ka qenë dhe mbetet qeveria më e dobët në historinë e Kosovës, ka qenë dhe mbetet Qeveria më e dobët në Ballkan, mirëpo si krejt qytetarët e Kosovës kemi shpresuar se ndoshta do të kemi ndryshime, ndryshime për shkak të asaj se Kosova është në një krizë të madhe ekonomike dhe sociale, ndryshime për shkak se qytetarët e Kosovës nuk kanë përjetuar diçka konkrete në jetën e tyre as në këto 6 vitet fundit.

Sot kjo seancë zhvillohet me 10 mars të vitit 2006. Më lejoni t'ju kujtoj se nesër është 25 vjetori i demonstratave të vitit 1981. Unë nuk do të flasë për histori, besoj që shumë të tjerët do të kanë të drejtë të flasin për histori e më lejoni vetëm që të përmendi një fakt; që 25 vite Kosova është në një gjendje të jashtëzakonshme ku vazhdimisht ka pasur gjysmë qeveri, semi qeveri ose kuazo qeveri të cilat nuk kanë qenë në gjendje t'i adresojnë nevojat e qytetarëve të Kosovës. 25 vite, një çerek shekulli është gjendja në të cilën është aktualisht Kosova. Për mua gjendja e jashtëzakonshme nuk është vetëm nëse shtrohet dilema a ka ose nuk ka policë dhe hegjemoni serbe në Kosovë, gjendja e jashtëzakonshme është vetëm një shembull e cila do të përmendi.

Kosova ka 2 milionë banorë, në mesin e atyre 2 milion banorëve 70 mijë deri 80 mijë janë nën moshën 25 vjeçare që kanë lindur pas vitit 1980/81. Kanë lindur në një situatë të konfliktit, janë rritur në konflikt, qasjet e tyre për të kaluarën, qasjet e tyre për të ardhmen, qasjet e tyre për të tashmen zakonisht janë qasje të një shoqërie e cila është përcjellë në konflikt. Çfarë kanë pasur këta 80 mijë njerëz të rinj gjatë këtyre 15 muajve, ti përmendi disa fakte, mjerisht ministri i arsimit nuk është këtu.

Edukimi parashkollor -32 paralele të edukimit parashkollor janë mbyllur nga dhjetori i vitit 2005. Shkolla fillore dhe shkolla e mesme është skajshmërisht e politizuar, gjithë drejtorët të cilët janë në shkolla fillore dhe në shkolla të mesme

janë edhe kryetarët të LDK, të nëndegëve të ndryshme. Klasa e nëntë si e tillë është e dështuar, tekstet historike janë më të politizuara se sa kanë qenë të politizuar në kohën e komunizmit, dhe në mënyrën më të dobët e prezantojnë realitetin aktual dhe në mënyrën më të dobët e prezantojnë atë në të kaluarën.

Universiteti i Prishtinës për herë të parë gjatë vitit të kaluar dhe këtij viti nën këto 15 muajsh të kësaj qeverie ka përjetuar një ndërhyrje të Qeverisë, arsimit privat dhe universitetet private janë të nivelit të qebaptoreve.

Ministria për Arsim është ajo e cila për herë të parë në Evropë ka hartuar një ligj i cili rregullon çështjen e arsimit privat, për ndryshe asnjë vend tjetër në Evropë nuk ka ligj për arsim privat. Ky ligj nuk është asgjë tjetër vetëm se një rregullore e dobët për licencim dhe një mekanizëm i dobët i cili shërben se si Qeveria thjeshtë korruptohet. Për 800 mijë qytetarët e Kosovës pritet se një kabinet i ri do të sjellë kthesë. Ma merr mendja se ka qenë pritje reale dhe të drejta, mirëpo kjo është pothuajse e pamundur. Këtë gjë e ka konfirmuar edhe vetë z. Çeku, i cili para dy tri ditësh ka thënë se tjetër janë dëshirat e tjetër janë mundësitë, do të thotë që ne do ta kemi një Qeveri të dëshirave, ne do ta kemi ndoshta një kryeministër i cili meqë s'ka program politik, do të lëviz përsëri në botën e tij të dëshirave.

Kosova nuk ka mundësi të ketë ndryshime, kjo Qeveri nuk ka mundësi të sjellë ndryshime për tri probleme themelore.

Problemi i parë është i natyrës strukturore. LDK dhe AAK nuk janë në gjendje të ofrojnë alternativë tjetër të qeverisjes, nuk kanë mundësi. Aktualisht kanë kuadro të mirë, mirëpo këto 15 muajsh kanë treguar që në vend që të ofrojnë qartësi, stabilitet dhe qeverisje të mirë, ky koalicion ka ofruar mbi të gjitha të kundërtën, paqartësi. Këtë qeverisje dhe këtë koalicion të tria këto do ta përcjellin.

Problemi i dytë ka të bëjë me përmbajtjen. Ne sot do të debatojmë dhe ne sot ndoshta do të shkojmë ta votojmë një kabinet të ri vetëqeverisës, por ne nuk e dimë cili është programi i kësaj Qeverie që u shtrua deri më tash, ndërsa programin të cilën e ka ofruar qeveria Haradinaj nuk ka qenë reflektim i situatës në Kosovë. Ka qenë një përkthim i dobët nga gjuha angleze dhe ka qenë një program i hartuar për 24 orë. Dhe problemi i tretë që ka të bëjë është me motivin, gjithë deputetët dhe gjithë ata të cilët kanë ambicie dhe interesat të hyjnë në politikë e dinë që njerëzit hyjnë në politikë për dy qëllime, ose të jetojnë prej saj, se kabineti aktual vetëqeverisës jeton prej politikës, ose ta ndryshojnë atë. Dëshira ime personale kishte me qenë se z. Çeku mos të hyjë në grupin e parë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Ju faleminderit z. Hoxhaj, fjalën e ka Gani Koci, le të përgatitet akademik Sabri Hamiti.

DEPUTETI GANI KOCI

Ju faleminderit z. kryetar
Të nderuar deputetë,

Fjala ime do të jetë shumë e shkurtër. Të gjithë jemi të vetëdijsëm dhe sigurisht edhe mbamendjen e kemi akoma të freskët rreth qëllimeve, synimeve dhe vizioneve që ka pasur ky koalicion prej kohës kur ka marrë mandatin e vet dhe nuk dua tani t'i përmend, por të vetmen gjë që ka arritur ky koalicion është kjo: që është kah i hanë kryeministrat e vet dhe aq më keq është kah i han, kah i gëlltitë gjeneralët.

E kuptoj për partinë më të madhe sepse është partia paqësore dhe nuk ka dashur kurrë të ketë as gjeneral e as ushtarë, por nuk e kuptoj për partinë tjetër që me gjithë atë ka dhënë edhe ushtarë, ka dhënë edhe gjeneral që tani radhën e ka gjeneral Çeku. Po i them për herë të fundit gjeneral Çeku dhe nuk di sa do t'i zgjasë mandati më shumë se gjeneral Haradinajt. Është dashur që ky ta ketë këtë parasysh, sepse misioni i këtij koalicioni është shkatërrimi i atyre që vërtetë kemi pritur dhe kanë premtuar se do bëjnë diçka.

Misioni më i madh i zotit Çeku do të ishte që ta kryen mandatin e vet atje ku e ka pas dhe të sjell trupat mbrojtëse të Kosovës aty ku ka qenë qëllimi që të sillen dhe tek atëherë si sukses i tij, si rezultat i tij do të kishte mund të futet edhe në politikë. U tha këtu nga disa se nuk është rasti i parë që gjeneralët të vijnë në politikë dhe të udhëheqin shtetin. Është e vërtetë edhe De Goli në kohën e vet ka ardhur dhe ka udhëhequr shtetin, por dihet se çfarë ka bërë De Goli, por kemi edhe shumë raste në Amerikën Latine se në çfarë mënyre kanë ardhur.

Një, do të pranoj ardhjen e Çekut në këtë funksion sikur ky të kishte ardhur me njerëz të ri, me kabinet të ri, ndërsa kabineti që është sot këtu i prezantuar absolutisht s'është kabinet i ri është i njëjti kabinet dhe si i tillë dështimi do të jetë i gatshëm edhe për gjeneral Çekun. Nëse ka pranuar që të dështojë, ndoshta prej asaj që ishte në krye të listës si personalitet të bije në fund të listës atëherë ja pafte hajrin kësaj pune.

Ndërsa sa i përket disa të tjerëve këtu që ndoshta më mirë do të ishte të mos ishin këtu fare, po të shkojnë të përkundin djepa, nëse mund të përkundin. Duhet ta dinë se koha e gjeneralëve në politikë ka përfunduar. Ata duhet të përfundojnë misionin

e tyre si gjeneral dhe tek pastaj nëse dëshirojnë të futen në politikë, mund të futen, por jo në mënyrën se si kanë ardhur dhe si vijnë me lojna të ndryshme prapa skenave për qëllime të ndryshme.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Faleminderit z. Koci, fjalën e ka akademik Sabri Hamiti, pastaj i fundit është Zef Morina.

Lus deputetët që janë jashtë sallës të kthehen në sallë se duhet të votojmë.

DEPUTETI SABRI HAMITI

Z. kryetar i Kuvendit!

Më së pari ta uroj këtë funksion dhe të dëshiroj edhe fuqi, edhe durim, edhe shëndet që ta kryesh me sukses, natyrisht në marrëveshje me gjithë neve që jemi këtu.

Për disiplinë parlamentare dhe institucionale unë nuk kam çfarë të shtoj, pos të përkrahi mendimin e shprehur nga kryetari Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës lidhur me pikën e rendit të ditës që kemi këtu. Po si deputet i përgjegjshëm, para njerëzve dhe vetvetes unë i jap vetit të drejtë dhe kam nevojë të them disa fjalë lidhur me disa çështje që u shtruan dhe lidhur me pikën e rendit të ditës.

Është interesante që mua po më duket kjo ditë e sodit është një farë tip i hymjeve në civilizim me dhunë, do të them në dy mënyra.

Një, se po flitet këtu edhe me humor po flitet edhe arsyeshëm po flitet edhe me brengë që tregon që situatat në këtë parlament edhe situatat serioze mund të jenë shumëngjyrëshe.

Nën dy, sepse ne e kemi një ushtarak i cili po hyn në botën e civilizimit, botën civile të politikës dhe kjo është e vërtetë. Unë dëgjova këto ditë disa breshni fjalës rreth Agim Çekut që vijnë, unë jam një njeri që maj në mend pak si shumë dhe më duken krejt të ngjashme me ato që janë thanë Haradinajt për afërsisht, kjo është e drejtë e opozitës edhe gjithkujt që të shprehë mendimet e veta, po është problemi që duhet kujdesen njerëzit a janë të besueshëm sepse është problem të bëhet njeri publikisht i besueshëm nëse figurat e veta emblematike me të cilat krenohet për një herë thotë nuk vyejnë gjë, por kjo është problem që të mendojmë për këtë kush i thotë.

Në anën tjetër unë dëgjova këtu kualifikimet që erdhën nga dy anëtarët, t'i quaj krahu të opozitës që u thanë formulime të forta, do t'i quaj tsha unë më shumë me

tiketa se sa karakterizime, u tha që kjo ose ajo pa u përcaktuar Qeveria e krimit dhe Qeveria e shantazhit. Shikoni, këto janë kualifikime shumë të rënda dhe shumë të forta dhe kur epen pa analiza nuk janë tjetër veçse etiketa në parlament, që është shtëpia më e fortë e të folurit dhe dokumentimit të folurit, etiketat nuk thonë gjë, unë po ju garantoj që bile bëjnë efekt kundër, sepse më shumë mbulojnë se sa zbulojnë. Për kundër kësaj, unë mendoj që ky parlament që sot por edhe më heret por që sot, sidomos që sot merr përgjegjësi jashtëzakonshme për Qeverinë që do të mandatojë. E mirë, e keqe, ky parlament definitivisht do ta merr përsipër përgjegjësinë për Qeverinë që mandaton, nëse jo tjetër ta di ta merr në dije që e ka të drejtën ta ç'mandatojë jo opozita, po pozita vetë dhe nëse ky parlament nuk e din me ushtrinë këtë detyrë të veten kushtetuese, atëherë kot flasin me fjalë të mëdha qofshin me humor, qofshin seriozisht, sepse nuk e ka marrë detyrën që ka. Unë thërras që ky Parlament ta ushtrojë këtë detyrë me analiza, me përcjellje të punës, njerëzve që mandatohen, të thuhet haptas që nuk e synon Qeveria Parlamentin, por Parlamenti është ai që e mandaton dhe e kontrollon Qeverinë, kjo është esenciale dhe funksioni i këtij Parlamenti do të vijë në vend atëherë kur e merr fuqinë çdo dy javë, a çdo muaj, qysh të mblidhet, të thërras në përgjegjësi ministrat ose Qeverinë e plotë, të jap përgjegjësi për punën e bërë. Unë e di që ky koalicion thotë që i ka dy anekse në marrëveshjen për këtë punë, por ne do ta kapim këtë koalicion ta detyrojmë që t'i realizojë kërkesat e veta. Kjo sa i përket raportit Parlament – Qeveri, kot ne bëjmë shou të bukur këtu, nëse nuk jemi te zot ta ushtojmë detyrën kushtetuese që e kem, e kjo është që të kontrollohet Qeveria qoftë e mirë, qoftë e keqe.

E dyta, kjo ka të bëjë me një frazë që e dëgjova unë këtu, rreth statusit u tha, e dëgjova atë frazë, mua më duket që e tha Surroi, nuk jam i sigurt, po le të të punohet këtu, sepse ka kush të merret me statusin, e unë këtu nuk pajtohem me Surroin, as me kërkend.

Ju lutem, shumë ne këtu edhe sod jemi duke folur për statusin, a e dini pse, sepse ekziston një pesëshe e mandatueme, dy me emra dhe tre me funksione, në këtë Kuvend i cili pretendon që e ka marrë barrë ta zgjidh statusin e Kosovës. Unë edhe atëherë kam thanë edhe tash, e kanë kot ai pesësh, që mendojnë që e kanë barrë ta ndreqin statusin e Kosovës, ata janë instrument i këtij Kuvendi dhe vetëm i këtij Kuvendi dhe ky Kuvend e ka përgjegjësinë edhe me një rezolutë që e ka aprovua vet, që të mos pranojë as far zgjidhje e cila nuk është në pajtim me vullnetin politik të qytetoreve të Kosovës. Pse po thamë, se kjo padukshme është, na veç dy anëtarë të dikurshëm të pesëshes i kemi ndërrua dhe sod do te ndërrohet i treti. Kjo është shumë esenciale koleg te nderuar, shumë esenciale kjo, prandaj edhe në këtë pikë Parlamenti duhet të marrë fuqinë që e ka kushtetuese, dhe ky parlament edhe sod, pikërisht tash kur për shkak të funksioneve po nderohet përbërja e një ekipi që pretendon që e ka barrën e ndreqjes së statusit të Kosovës, të marrë përgjegjësitë e tij të mëdha rreth, rreth pesëshes, rreth statusit. Faliminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Ne ju faleminderit prof. Hamiti. Fjalën e ka deputeti Zef Morina. Lus edhe një herë deputetët që gjenden jashtë sallë të kthehen në sallë, sepse do të votojmë.

DEPUTETI ZEF MORINA

Faleminderit z. kryetar. Më lejoni së pari t'ju uroj detyrën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës.

Nuk e pata ndërmend ta marrë fjalën, por natyrisht edhe unë si deputet dhe si anëtar i partisë dëshiroj t'i them disa fjalë, e posaçërisht pas fjalëve që dëgjova nga prof. Marku. Nuk besoj që ka qytetarë të thjeshtë e lerë më deputet, të cilët në një mënyrë apo tjetër nuk janë duke punuar, dhe nuk punojnë për pavarësinë e Kosovës. Ndërsa, ne deputetët e kemi obligim që, përveç punës tonë, që bëjmë natyrisht të angazhohemi dhe të kontrollojmë edhe punën e Qeverisë, të cilën ne vetë e kemi zgjedh. Nuk pajtohem që mos rezultati i Qeverisë ka qenë vetëm ish kryeministri Kosumi, por me siguri kanë qenë edhe disa ministra të cilët edhe vetë e dinë që janë aty falë votës së njerëzve, të cilët në një mënyrë e përkrahin edhe pse nuk meritojnë të jenë aty. Nuk është në rregull që mandatarin, për cilin kam respekt shumë të madh, të kërkojë votën e deputetëve, pa u ofruar programin për Qeverinë të cilin do ta udhëheqë. Detyrë e jona është që të gjithë së bashku t'i ndihmojmë edhe Qeverinë edhe Parlamentin që detyrën e vetë ta kryejnë me nderë dhe ta kryejë ashtu siç e meriton Kosova dhe e meriton populli për të cilët na kanë zgjedh.

Unë dëshiroj të them që dy qeveritë, të cilat më parë janë votuar janë votuar nga pozita vetëm dhe me siguri që edhe kësaj radhe do të votohen ashtu, dhe me siguri që prof. Marku nuk mund të votojë dy herë por vetëm një herë, se vetëm një votë e ka. Kështu që, unë mendoj që më mirë të ishte me qenë që të na ofrohet programi dhe të shikojmë se çfarë programi kemi dhe në çfarë afati kohor do të realizohet ai program. Vërtetë atë votë që e japim, që pa dyshim do ta japim, të dimë që jemi duke dhanë dhe të kemi edhe ne një mënyrë të prezantimit tek elektorati edhe tek qytetarët tanë.

Nuk mendoj që duhet të hezitohet a duhet të mendojë dikush unë jam kundër absolutisht jo, por si deputet e kam për obligim që të kërkojë vërtetë përgjegjësi nga ata të cilët e dinë edhe vet sa kanë punuar gjatë mandatit të kaluar të Qeverisë dhe tash ende janë dhe ende kërkojnë të jenë në Qeveri. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Faleminderit z. Morina, për replikë është paraqit z. Veton Surroi, urdhëroni. Natyrisht e dini se dy minuta i keni në dispozicion.

DEPUTETI VETON SURROI

Replikë e shkurtër e deputetit Sabri Hamiti.

E para. Qeverinë e kam quajtur të shantazhuar, domethanë këtë propozim, sepse mendoj se është e shantazhuar, domethanë nuk kam dashur të shpikë ndonjë termë, mendoj se është e shantazhuar, ashtu siç e kam shpjeguar, shantazhuar nga fakti se ministrat thonë nuk duan të largohen, sepse për ndryshe nuk japim votat nga fakti se koalicioni thotë se mund të sajojë tash për tash vetëm kësi ekipi, sepse për ndryshe nuk mund të sigurojë votat. Ky është shantazhim i deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe i popullit të Kosovës me ngjarjet e vogla në relacionet e grupeve brendapartiake.

Çështja e dytë e negociatave është çështje të cilën plotësisht pajtohem me ju, unë vetëm e kam spikatë anën tjetër, do me thanë unë plotësisht pajtohem se doemos zgjedhja e Qeverisë, zgjedhja e kryetarit të Kuvendit është pjesë e procesit negociator, është pjesë e demokracisë, është pjesë e sundimit të ligjit, por kam tërhequr vërejtjen për Qeverinë e cila duhet të zgjidhet në të ardhmen, që të mos shërbehet me procesin negociator të statusit si mburojë.

Çështja e statusit në pjesën e vet negociatore e ka ekipin e vet, çështja e statusit në pjesën e vet funksionale të shtetit e ka pjesën e vet dhe kjo quhet Qeveria dhe quhet Parlamenti, ajo çka nuk duhet bashkëdyzuar është procesi negociator me procesin e zhvillimeve të brendshme, gjegjësisht nuk duhet t'i shërbejë si alibi Qeverisë për ngecjen e vet. Kaq.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Faleminderit. z. Sabri Hamit.

DEPUTETI, SABRI HAMITI

Z. Surroi, unë pëlqej retorikën tënde por unë me gjithë atë dua të kthehem në thelb. Unë desha të jem i qartë, duhet të bëhem edhe më i qartë. Atë grup negociator në atë formacion tre funksione dhe dy emra si formulë, ne këtu e kemi votuar, desha t'ju them që ky Kuvend e ka përgjegjësinë kushtetuese, me ju tek me e ç'votue. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Faleminderit. Debati ka marrë fund. Edhe shkojmë në votim.

E kemi propozimin e grupeve parlamentare për integrim dhe ORA, në pajtim me rregullin 18, pika 3 të Rregullores së punës për mundësinë e votimit të fshehtë. Kërkoj që Kuvendi, me votim, të deklarohet për mënyrën e votimit për zgjedhjen e Qeverisë.

Ka mbaruar debati zotëri, urdhëroni z. Buja.

DEPUTETI RAMË BUJA

E kam për procedurën, debati përfundoi, jam i ndërgjegjshëm për këtë. Por çështja që nuk dua ta pengoj është ajo që të votohet për apo kundër një çështje, por tani në kafe unë marrë vesh se ka deputetë që janë shantazhuar dhe keq janë shantazhuar, andaj për të qenë prezente në këtë Kuvend tamanë logjika demokratike e veprimit do të ishte mirë që ne të votojmë fshehtë, e pastaj askush nuk ndihet keq.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Alush Gashi e ka fjalën. Shefi i Grupit parlamentar i LDK-ës.

DEPUTETI ALUSH GASHI

I nderuari z. kryetar i Kuvendit. Fatmirësisht, kjo nuk është hera e parë që Kuvendi i Kosovës zgjedh Qeveri, në të gjitha zgjedhjet e mëparshme votimi për Qeveri ka qenë votim i hapur. Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës së bashku me Grupin Parlamentar të Aleancës si dhe të 6+ kërkon që votimi të jetë i hapur. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA

Ju faleminderit. shkojmë në procedurën e votimit.

Po e përsërisë edhe një herë, Kuvendi duhet të deklarohet për mënyrën e votimit, të votojmë me vota të fshehta apo me vota të hapta. Me qenë se kemi një mocion, një kërkesë të dy grupeve parlamentare të këtij parlamenti, Grupi Parlamentar për Integrim dhe ORA, e vejmë në votim kërkesën e tyre për votim të fshehtë.

Kush është për? Në sallë kemi 105 deputetë, kush është kundër? Ju faleminderit, kush abstenon?

Për	39;
Kundër	64;
Abstenim	1.

Nuk ka kaluar propozimi për votim të mësheftë.

Shkojmë në votim për Kabinetin qeveritar.

Ju lutem, nuk është vendi për gazetarë ende, na lejoni të punojmë ju lutem, do të thërrasim prapë.

Për	65;
Kundër	33;
Abstenim	5 .

Duartrokitje.

Aprovohet, miratohet propozimi për Qeverinë e re Çeku.

Zotëri kryeministër i posa zgjedhur, urdhëroni e keni fjalën!

Zotëri kryeministër, e keni fjalën në emër të Kabinetit qeveritar të ardhshëm.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU

I nderuar zoti Jesen Petersen!

I nderuar zoti kryetar i Kosovës!

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,!

Të nderuar deputetë!

Të nderuar të pranishëm!

Posa mora besimin tuaj për të qeverisur vendin dhe për këtë Ju falënderoj.

Sot, po ashtu, po e marr një obligim të madh për ta udhëhequr Qeverinë, për t'i përmbushur obligimet ndaj qytetarëve të Kosovës dhe për këtë jam i nderuar. Sot mora mandatin për të udhëhequr Qeverinë, ndoshta në kohën më të vështirë dhe më vendimtare. Dhe për këtë jam i gatshëm.

Në këto momente kyçe për Kosovën dhe për popullin e saj besimi i juaj do të jetë pikëmbështetje e punës sime në udhëheqjen e Qeverisë së Kosovës. Me marrjen e kësaj përgjegjësie, ne ju themi juve dhe qytetarëve të Kosovës se qeverisja e jonë do të jetë e bazuar në mirëqenien e qytetarit të Kosovës,

pavarësisht dallimeve etnike, fetare apo politike. Synimet tona të përbashkëta do t'i realizojmë në bashkëpunim me të gjithë ju dhe me miqtë tanë ndërkombëtarë.

Parimet e qeverisë të cilën do të drejtoj unë burojnë nga programi qeveritar. Do të përqendrohemi në forcimin e mëtejshëm të institucioneve, punësimin dhe përmirësimin e kushteve ekonomike të qytetarëve të Kosovës, forcimin e stabilitetit politik dhe të sigurisë, përmirësimin e qeverisjes dhe kuadrit ligjor si dhe dinamizmin e punës rreth përmbushjes së standardeve, me qëllim të krijimit të rrethanave sa më të volitshme për njohjen e pavarësisë së Kosovës në një kohë sa më të shpejtë.

Ndonëse gjendemi në fazën kryesore të procesit të krijimit të shtetit të Kosovës, synimet tona nuk përfundojnë me kaq. Ne kemi ende për të bërë drejt realizimit të aspiratave tona.

Ne duam një Kosovë demokratike dhe tolerante, të integruar në strukturat e Bashkimit Evropian dhe në NATO. Ne duam një Kosovë që është burim i stabilitetit në rajon dhe katalizator i zhvillimeve pozitive në këtë pjesë të Evropës. Krijimi i shtetit të Kosovës është vullneti i popullit të Kosovës, ashtu siç është edhe i qeverisë kosovare.

Ky synim na obligon që përgjegjësitë tona ndaj këtij procesi t'i realizojmë me përpikëri. Shteti i Kosovës është objektiv madhor e i përbashkët i të gjithë neve. Por, në të njëjtën kohë, mirëqenia, siguria dhe perspektiva ekonomike janë përgjegjësi të Qeverisë, që në asnjë mënyrë dhe për asnjë qëllim nuk do të anashkalohen.

Qytetari i Kosovës do të jetë në qendër të punës dhe të veprimeve tona. Ne, si qeveri do të jemi të hapur ndaj të gjitha detyrimeve, duke u ballafaquar me sfidat e qeverisjes, pa e harruar se për punën tonë duhet t'i japim llogari këtij parlamenti dhe qytetarëve të Kosovës.

Ne do të krijojmë qeverisje të përgjegjshme dhe efektive, që i përgjigjet nevojave të qytetarit të Kosovës. Në Qeverinë e Kosovës nuk do të ketë vend për ata që nuk do të jenë shembuj të politikanëve të zotë, të përgjegjshëm, të përkushtuar dhe të ndershëm. Për këtë unë zotohem se do të japë gjithçka nga vetja për t'i dalë zot mandatit dhe besimit që më është dhënë sot.

Zonja dhe zotërinj,

Ne do të punojmë që të krijojmë ura të mirëbesimit në mes të njerëzve të Kosovës dhe do të arrijmë që dallimet ndëretnike t'i shndërrojmë në vlera të shoqërisë sonë. Qeveria e Kosovës do të kultivojë klimën e mirëbesimit dhe të bashkëpunimit të

ndërsjellë, me qëllimin më të mirë që Kosova të jetë shtëpi e të gjithë qytetarëve të saj.

Koha e urrejtjes, diskriminimit dhe vuajtjeve për qytetarët e Kosovës duhet të i takoj së kaluarës. Ka ardhur koha e pajtimit ndëretnik e integritimeve dhe prosperitetit të gjithmbarshëm.

Një gjë është e qartë për të gjithë. Nuk ka liri të plotë në Kosovë përderisa të gjithë qytetarët e Kosovës nuk e gëzojnë atë.

Popullata shumicë e Kosovës, ne shqiptarët duhet të dijë se çelësi i realizimit të synimeve të shumicës në Kosovë është mirëqenia dhe respekti për popullatën pakicë.

Andaj kujdesi ndaj pakicave është interes i shumicës. Komunitetet pakicë në Kosovë duhet të besojnë se interesat e tyre do të avancohen dhe do të mbrohen në Kosovën që ne sot po ndërtojmë andaj bashkëpunimi i ngushtë dhe konstruktiv i tyre shpejton këtë proces të rëndësishëm për ardhmërinë e Kosovës.

Komuniteti Serb i Kosovës duhet të besoj se shoqëria që po e ndërtojmë do të mbështetet në parimet më të larta njerëzore të tolerancës dhe mirëbesimit andaj e konsideroj të rëndësishme që nga ky vend të Ju drejtohem edhe në gjuhën e tyre: pasi pretendoj që të jem kryeministër i gjithë qytetarëve të Kosovës.

“U demokratskom Kosovo i vi Srbi kao i svi drugi gradani Kosovo imate i imacete budućnost. Kosovo pripada svima i svi zajedno cemo stvoriti društvo koja garantuje, slobodu, ravnopravnost i ekonomski napredak za svakoga, bez obzira na nacionalnu pripadnost. U to treba da verujte. Za ovakvo društvo, za ovakvu budućnost, treba da se izborite zajedno sa svim drugim građanima Kosova, sudjelujući u Vladi, u Skupstinu, u opstinama, u institucijama i u svakodnevnom zivotu Kosova.”

Për krijimin e Kosovës vend demokratik dhe prosperues implementimi i standardeve është një nga lokomotivat e rëndësishme që shpejton këtë proces, andaj dinamizimi i punës për implementimin e standardeve do të zë një vend të rëndësishëm në agjendën tonë qeverisëse.

Që nga ditët e ardhshme do të fillojmë me aktivitete të ngjeshura për implementimin e standardeve. Dhe jo pse këtë na ka vënë kusht bashkësia ndërkombëtare, por për shkak se me përmbushjen e tyre i ndihmojmë vetes. Andaj ju sigurojmë se vlerësimet nga bashkësia ndërkombëtare por edhe nga qytetarët e Kosovës do të reflektojnë angazhimet tona, veprimet tona dhe si të tilla, ato do të jenë pozitive.

Përmbushja e standardeve do të jetë argumenti jonë më i fortë në bisedimet për statusin e Kosovës. Qeveria do të luajë rol konstruktiv në procesin e bisedimeve duke e konsideruar statusin çështje të përbashkët jo vetëm të qeverisë dhe duke bërë çmos për ta ruajtur unitetin e gjithë spektrit politik në këtë proces.

Për ta shprehur qëndrimin tonë rreth procesit të bisedimeve, më lejoni të citoj presidentin e ndjerë amerikan JF Kenedi, i cili thoshte: “Kurrë nuk do të negociojmë nga frika, por kurrë nuk do të frikohemi të negociojmë “

Ju ftoj që të jemi të bashkuar në këtë proces, unik dhe të paluhatshëm. Nuk guxojmë të lejojmë përçarje. Nuk kemi hapësirë për gabime dhe nuk kemi kohë për t’i përmirësuar gabimet eventuale, me mua në këtë proces nuk do të ndahen rrugët me askend.

Zonja dhe zotërinj,

Shtatë vjet pas përfundimit të luftës, Kosova vazhdon të ballafaqohet me një sërë krizash të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve dhe në ekonominë e vendit. Papunësia është duke u shndërruar në një sëmundje kronike të shoqërisë sonë.

Furnizimi me rrymë vazhdon të jetë një problem i madh, me gjithë investimet e mëdha që janë bërë. Infrastruktura e Kosovës ende vuan nga mungesa e cilësisë, kurse arsimit dhe shëndetësia janë në një gjendje e cila kërkon shqyrtim serioz nga të gjithë ne. Duhet ta ruajmë dinjitetin e pensionistëve, mësimmësuesve, mjekëve , ushtarëve dhe policëve tanë.

Ne nuk premtojmë zgjidhje të të gjitha problemeve nga të cilat vuan sot Kosova. Por, në emër të Qeverisë të cilën do ta drejtoj, zotohem se do të punojmë që këto çështje të kenë vëmendjen dhe përkushtimin tonë më të madh gjatë punës sonë të përditshme.

Qeveria do të krijojë politika adekuate ekonomike dhe legjislacionin e nevojshëm që të tërheqë investimet në industri, biznes dhe në arsimimin e njerëzve sipas nevojave ekonomike të vendit. Ne duhet ta shfrytëzojmë pozitën tonë gjeografike dhe resurset tona natyrore dhe njerëzore që t’u ofrojmë investitorëve të huaj mundësi tërheqëse për investime.

Qeveria do të përkrahë dhe do të ndihmojë procesin e privatizimit, por do të punojë intensivisht që të tërheqë edhe investime të tjera në ekonominë e Kosovës. Ne duhet të shikojmë jashtë kornizave ekzistuese dhe të krijojmë një vizion të ri për një ekonomi të qëndrueshme dhe të krijojmë perspektivë për të rinjtë dhe për

fëmijët tanë.

Zonja dhe Zotërinj,
Ladies and Gentlemen,

Me lejon që më disa fjalë t'ju drejtohem edhe komunitetit ndërkombëtar në gjuhën angleze.

We are very grateful to the United States of America, NATO, the European Union, United Nations and all of our friends who have helped us during our difficult times. We aim to continue building our political and economic capacities as well as to work on building a secure environment for all in order to self-govern our country so that our citizens and international friends take pride on.

From here, from the Kosova Parliamentary Assembly, we emphasize our duty to continue the cooperation with Mr. Ahtisari, Special Envoy for the final status, and the members of the Contact Group to resolve the status of Kosova. We strongly believe that the state of Kosova, which will be created at the end of this process, will be a democratic state that will be the beloved homeland for all of its citizens.

Zonja dhe Zotërinj,

Pavarësisht se edhe pas statusit do të ketë prezencë të NATO-s në Kosovë, gjë që para se gjithash është vullnet i qytetarëve të Kosovës, ne do të punojmë me përkushtim për të ndërtuar sistemin tonë të sigurisë, përfshirë edhe forcën mbrojtëse të Kosovës. Këtë do ta bëjmë në partneritet të plotë me NATO-n dhe miqtë ndërkombëtarë.

Kosova do të zhvillojë politika të mbrojtjes dhe sigurisë që në thelb do të ketë sigurinë e qytetarit të Kosovës dhe krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt për të gjithë. Kosova nga një vend konsumues i sigurisë duhet të shndërrohet një vend që prodhon dhe reflekton siguri. Koncepti ynë i sigurisë do të bazohet në bashkëpunim me NATO-n dhe fqinjët. Ne do të përpiqemi për ta bërë Kosovën kontribuuesin më të madh të paqes dhe sigurisë në rajon.

Një kujdes të veçantë do të tregojmë për ruajtjen dhe avancimin e vlerave të mëdha të luftës . Unë për asnjë çast nuk do të harroj se prej nga vij sepse ai që nuk e din se prej nga vjen nuk e din se ku do të shkon. Unë jam krenar pa marrë parasysh Sokol, se kam qenë luftëtar i UÇK-së dhe ushtar i komandantit legjendar Adem Jashari, çfarëdo që thuash t'i. Çdo ditë të punës sime si kryeministër do ta filloj duke pasur në mendje këto vlera të shenjta për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Përkujdesja për kategoritë e dala nga lufta: familjet e dëshmorëve, të të rëndëve për lirin e Kosovës, invalidët dhe veteranët e luftës, zbardhja e vatit të të zhdukurve do të jenë në fokus të angazhimit tim. Ne u jemi shumë borxhli këtyre kategorive, të cilat meritojnë kujdes më të madh nga të gjithë. Sa më shumë që po afrohet statusi i Kosovës aq më i madh bëhet borxhi ndaj tyre.

Shumë shpejt Kosovës do t'i jepet mundësia e pjesëmarrjes në ngjarje kulturore dhe sportive ndërkombëtare. Andaj ne një kujdes të veçantë do t'i kushtojmë kulturës, sportit dhe artit.

Gjithashtu edhe diaspora do të zë vend të merituar në programin e Qeverisë sonë dhe punën tonë të përditshme.

I nderuar zoti kryetar i Kosovës,
I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,
I nderuar përfaqësues special i sekretarit të përgjithshëm,
Të nderuar deputetë,

Unë sot ju premtoj edhe një herë se nuk do të kursehem në punën tonë. Në të njëjtën kohë, mbështetja e të gjithë juve për Qeverinë e Kosovës do të jetë një garanci shtesë se popullin dhe vendin tonë e presin ditë shumë më të mira. Unë e kërkoj pra këtë mbështetje nga të gjithë ju duke ju premtuar se mbështetja e juaj do të shpërblehet me suksese reale dhe shumë të prekshme të vendit tonë, Kosovës.

Ju ftoj juve të gjithëve deputetë të Kosovës që në frymën demokratike të vazhdoni të jeni kritike ndaj Qeverisë. Të theksoni dhe argumentoni çdo parregullsi eventuale në qeverisje. Me këtë do t'i përmbushni edhe obligimet e juaja ndaj votuesve të juaj, ndaj qytetarëve të Kosovës dhe do të ndihmoni qeverinë që të punojë më mirë.

Dua të theksoj në fund se me qeverinë që do të kryesoj unë nuk fillon asgjë nga e para. Ne do ta vazhdojmë kontinuitetin e qeverive para nesh dhe do të përpiqemi më të gjitha forcat për ta dinamizuar dhe bërë sa me efikase këtë Qeveri. Dëshiroj të falënderoj me këtë rast të gjithë kryeministrat para meje z. Bajram Rexhepi, z. Ramush Haradinaj dhe z. Bajram Kosumi por edhe presidentin e ndërë Ibrahim Rugova dhe kryetarin e deritashëm të asamblesë, akademik Nexhat Dacin, të cilët kanë krijuar një bazë të mirë qeverisje, mbi të cilën mund të mbështetem gjatë punës sime.

Ne jemi brezi më me fat në historinë e Kosovës. Ne na zgjodhi historia për ta

sjellë lirinë në Kosovë bashkë me miqtë tanë. Këtu nuk ka asgjë të falur çdo gjë është arritur me sakrificën e shumë brezave të popullit tonë. Jemi para fitores përfundimtare. Pas sakrificave nuk ka asgjë më të kotë se sa ngarendjen për të përvetësuar fitore. Fitorja është e Kosovës, e popullit dhe e qytetarëve të saj.

Ju Faleminderit për vëmendje!

(Duartrokitje nga deputetët në sallë)

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit z. Çeku.

I nderuari kryeministër Çeku.

Shfrytëzojë rastin që juve dhe kabinetit tuaj t'ua urojë sukses dhe punë të mbarë. Ndërkaq deputetë të nderuar ju faleminderit për mirëkuptim.

Seanca përfundon punimet sot.